

# Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT  
Tel: 020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob: 078 5997 7545




# The Albanian

VITI I 21 I BOTIMIT 25 PRILL 2025

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

## ËSHTË KOHA E DIASPORËS



PETRIT KUÇANA

**VOTA  
SI SHKUNDJE  
E FUSHATËS  
TALLAVA**




**A DUHET BESUAR  
HEKURUDHA  
TIRANË-PRISHTINË?**

LUTFI DERVISHI



**NJË PAPË KUNDËR  
POMPOZITETIT**

ENVER ROBELLI



**BUSTI I SKËNDERBEUT NË  
LONDËR I LËNË NË NJË GJENDJE  
SA QË BËN TË SHKUQET ÇDO  
SHQIPTARO-BRITANIK**

MAL BERISHA




**KRIZA E INTEGRITETIT DHE  
VETËVRASJET POLITIKE TË  
LIDERËVE TË RINJ**

ARBEN MALAJ



**SI (NUK) PO E  
MBROJNË  
SHQIPTARËT MALIN E ZI**

VETON SURROI



**E ARDHMJJA FILLON TANI**

**Dotech**  
websites

**JEPI FRYMËMARRJE  
BIZNESIT TËND**



PËR ÇDO KONSULTIM  
MUND TE VINI NË  
ZYRAT TONA

ADRESA E ZYRAVE:  
30 AVENONS ROAD  
LONDON E13 8HT

020 7018 7929  
073 4066 5946  
078 5997 7545


The Albanian newspaper in London

**THE ALBANIAN**  
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Krejtësisht e pakumtimtë duket gjithçkaja e asaj që po ndodh në Shqipëri, ndërkohë që fushata elektorale po shkon drejt fundit.

Mbetet thujse në kufinj të së pamundurës që t'i shpjegosh dikujt, që është i lindur në Britani apo në ndonjë shtet tjetër të Europës apo më gjerë, që kryeministri në zhangonin e tij nuk le pa përfshirë nuancat e pafundme të kopshtit zologjik dhe nuk ka, qoftë edhe një tendencë llogaridhënjeje, edhe pas 12- vitesh në qeverisje.

Tmerrësisht e vështirë është tu shpjegosh që kryeministri Rama (kurrë) nuk ka kërkuar qoftë edhe një ndjesë publike, ndonëse me rekordet e jashtëzakonshme të korrupsionit, kur thuhet gati shpërfillshëm se ka krijuar një grup parlamentar në burg.

Mbetet kaq i politizuar ambienti shqiptar, saqë do të konsiderohej e papranueshme që ky ministri, bie fjala, të kërkonte ndjesë për të gjithë ata që i kishte zgjedhur, por që kishin ngrënë kumbulla pas krahëve të tij, dhe se, kjo nuk do të ndodhte kurrë më, që kurrë më nuk do të kishte inceneratorë apo fenomene te tilla.

Duke qenë se ai ka një slogan për Shqipërinë në Evropë, mbase nuk do të ishte keq që të fillonte të sillej si evropian, (në rastin më të mirë do të ishte dorëhequr) dhe se, do të mjaftonte t'i hidhte një sy raporteve ndërkombëtare për zgjedhjet dhe të reflektonte; Kurrë më nuk do të përdorej administrata në zgjedhje.

Imagjini për një moment që kryeministri evropian do të dilte publikisht dhe të deklaronte që askush të mos guxonte t'i bëjë presion administratës dhe se ai vet personalisht, do të ndërhynte nëse do të kishte ndonjë rast të tillë.

Imagjini që në një univers paralel, kryeministri evropian të deklaronte

## VOTA SI SHKUNDJE E FUSHATËS TALLAVA

qartë dhe prerë, që askush të mos guxonte që të blinte vota dhe se personalisht do të interesohej edhe për dosjet e krimeve zgjedhorë të publikuara në Bild. Sikur.. sikur...

A do të ngjasonin kaq normale në një vend demokratik? Kaq të thjeshta, kaq të padiskutueshme, por në Shqipërinë tonë të dashur kjo nuk ndodh...

*Shumëkush nga të lindurit jashtë e konsideron Shqipërinë sa një lagje ku është rritur.*

Sa të vështirë do ta ketë të kuptojë, se pse bëhet e gjithë ajo tymnajë përpjekjesh propaganda të pakufishme.. Shqipëria me 2 milionë banorë që po ikin çdo ditë...

### Sa është numri i shkollave të mbyllura në 12 vjet qeverisjeje?

A kemi parë ndonjëherë kryeministrin t'i kërkojë ndjesë diasporës që për 12 vite rrjesht nuk bëri asgjë për ta? E drejta e votës?

Pasi u bënë mirë e mirë llogaritë?... Të kërkojë ndjesë që ua mbylli (shkriu) ministrinë për diasporën? Që nuk ua përmirësoi shërbimet nëpër ambasada dhe që mjerisht janë kthyer në konvikte diplomatike...

Mbase Londra mbetet një nga pikat më të turpshme të fjalimeve të tij...

Mbeten të paharrueshme pamjet e tmerrshme të qytetarëve protestues me barrela duke i dërguar nëpër spitale, me mëkatën e vetëm që protestuan paqësisht kundër kryeministrit të tyre....

Çfarë do të ndodhte nëse kryeministri të kërkonte ndjesë dhe të garantonte se një gjë e tillë nuk do të përsëritej më kurrë?

### Makinat me krah anglez

Që në 2013 me një VKM shqiptarëve të Britanisë u është mohuar që të dërgojnë makinat e tyre në mëmëdhe. Që nga ajo kohë e deri më sot kryeministri dhe qeveritë e tij as që e kanë vënë ujën në zjarr qoftë edhe që ta shqyrtojnë këtë çështje. Nëse flitet për Shqipëri në Evropë një nga elementet e para do të jetë shfuqizimi i këtij ligji pasi nuk ka vend të evropës që ka një ligj të tillë. Edhe sot e kësaj dite askush nuk e di se pse u vu ky ligj dhe çfarë interesash



mpleksen...

### Marreveshja Rama-Sunak

Rezultati i kësaj marrëveshjeje rezultoi në mbi 13 000 shqiptarë të kthyer sipas burimeve nga Ministria e Brendshme Britanike.

Sot e kësaj dite vazhdon kthimi i shqiptarëve dhe institucionet shtetërore as që e imagjinojnë që të kenë ndonjë projekt në ndihmë të tyre. Fatkeqësisht një pjesë e tyre rikthehen duke rënë pre e grupeve kriminale.

A mund të ketë ndonjë që të spjegojnë qytetarëve shqiptarë se çfarë përfituan shqiptarët nga kjo marrëveshjeje?

U konsiderua si një varkë shpëtimi për qeverinë e ish kryeministrit Sunak, por siç është parë deri më sot nuk ka patur asnjë përfitim për palën shqiptare. Qeveria shqiptare dështoi të bindë autoritetet britanike qoftë për një liberalizim të mundshëm të vizave, për kthimin në identitet të shqiptarëve të këtushëm (pra ata qytetarë që janë regjistruar nga vende të tjera, besohet se numri i tyre është goxha i madh). Pra mbi 13 000 të kthyerit a mund të bëhen pjesë e paketës së maleve, fushave apo bregdetit? A mund të jenë pjesë e ndonjë programi për zhvillimin e aftësive të këtyre të rikthyerve, që bie fjala të zëvendësojnë pakistanezët apo nepalezët që vijnë të punojnë në

Shqipëri?

### Potenciali njerëzor

Sa është numri i PHD doktorëve të shkencave shqiptarë nëpër botë? A ka një database për ta? Sa vite i duhen në pushtet një partie politike për të identifikuar dhe përfshirë jo thjet të skolluarit po ata që shkëlqejnë me talentin e tyre nëpër botë që do të ishte jo thjesht krenaria e çdo kombi, por pasuria më e paçmuar e tij. Prej 12 vitesh qeveria shqiptare nuk e ka parë të arsyeshme që të merret me këtë punë.

### Investitorët nga diaspora

Si është e mundur që në të gjithë ata të ashtuquajtur investitorë strategjikë nuk kemi asnjë nga diaspora? Është kjo pikëpyetje që duhet të godiste ballit çdo politikan qeverisës dhe se kurrësesi nuk duhet ta humbinin një mundësi të tillë.

Po sikur të kishte një 'zyrë' vetëm për investimet e diasporës?

Mjerisht qeveritarët mjaftohen me 1 miliardshin e eurove në vit që dërgon diaspora. Tek-tuk është dëgjuar për një 'paketë malesh' por që nuk ka asgjë konkrete e që ndoshta diaspora mund të presë edhe ndonjë 'paketë bregdeti'. Përse jo? Apo bregdeti është për strategjikët? Sa është numri i biznesmenëve shqiptarë në botë?

Mijëra e mijëra që vazhdojnë jetën e tyre pa guxuar që të kthejnë kokën nga mëmëdhe.

Si është e mundur që asnjë PPP nuk u është dhënë investitorëve nga diaspora? Asnjë projekt rrugësh apo koncesion?

A do të ishte i mirëpritur investimi i tyre në çdo vend të botës?

### Aeroporti i Kukësit

Është nga ato ngjarjet më të pabesueshme, që mbase do të përfshihet në turpet e historisë qeverisëse. Gjithkush që kujton gjithë atë propagandë për hapjen e aeroportit të Kukësit, mbase do të fillojë të mendojë se ka diçka që nuk shkon. Më së paku...

Ata që nuk mund të mendojnë më tepër sesa një nivel patronazhisti, do të mekeshin për të gjetur një arsye/shkak se përse me një të rënë të lapsit u mbyll aeroporti që besohej do të ishte një trampolinë e jashtëzakonshme e zhvillimit të turizmit. (Vini re! Askush nuk guxon ta përmendë aeroportin e Kukësit)

Sidomos për diasporën të bënte qoftë edhe atë aktin e fundit normal; ndihmën për arkmortet e shqiptarëve që të kthehen në atdhe...


A duhet të ishte llogaridhënia një process normal (europian) dhe nuk mund të tejkalohet me tallava?

You **Talk**  
We **Listen.**

4.9<sup>/5</sup>



*Because your case isn't just another file — it's your life.*



**Secure  
your right  
to work,  
live and be  
FREE in the  
UK.**



**Meet**

**OLIVERTA MEDIU**

Solicitor, Partner

**+44 (0)20 7063 9040**

Call now to book your confidential consultation!

079 4603 5736

o.mediu@wslegal.co.uk

**Leicester Office:**  
3rd Floor, St. George's House, 6 St George's  
Way, Leicestershire, LE1 1QZ, UK

**Head Office:**  
2nd Floor, 2-5 Minories,  
London EC3N 1BJ

**Immigration Law:**

- Visa applications & appeals (work, student, spouse, etc.)
- Indefinite Leave to Remain (ILR) & British citizenship
- Asylum & human rights claims
- Detention, bail, and deportation defense
- Sponsorship & business immigration

**Family Law:**

- Divorce & separation
- Child custody & visitation rights
- Domestic violence protection orders
- Prenuptial & postnuptial agreements

Providing expert legal support to all—  
regardless of race, nationality, age, gender, or identity.

# EDHE ANGLIA DËRGON REFUGJATË NË SHQIPËRI?

Qeveria britanike po përgatit një plan të ri për të dërguar azilkërkuesit e refuzuar në "qendra kthimi" jashtë vendit, një nismë që ka marrë mbështetjen e Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR). Burime të gazetës britanike "The Telegraph" e kanë përshkruar lëvizjen si "revolucionare", veçanërisht pas diskutimeve mes Sekretares së Brendshme britanike, Yvette Cooper, dhe drejtuesit të UNHCR-së për mundësinë e pagesës së vendeve në Ballkan për të pranuar azilkërkues të refuzuar nga Britania.

Sipas një tjetër gazete britanike, "The Times", qeveria në Londër po shqyrton ngritjen e disa qendrave jashtë vendit për të strehuar emigrantët e refuzuar, me Ballkanin si një opsion të mundshëm. Vendet që janë kontaktuar deri tani përfshijnë Shqipërinë, Serbinë, Bosnjën dhe Maqedoninë e Veriut, shkruan A2 CNN.

Një dokument i UNHCR thekson "nevojën për sisteme efikase të kthimit dhe rolin potencial të qendrave të kthimit", duke sinjalizuar mbështetje për vende si Mbretëria e Bashkuar, për sa kohë që nuk shkelet parimi i mbrojtjes së refugjatëve dhe të drejtat e njeriut. UNHCR ka theksuar se monitorimi i standardeve të të drejtave të njeriut në këto qendra do

të ishte kusht i domosdoshëm.

Modeli që po shqyrtohet është ai italian, ku Italia ka ngritur dy qendra të tilla në portin e Shëngjinit, në Shqipëri, për të përpunuar kërkesat për azil të emigrantëve të kapur në Mesdhe. Tani, Britania mund të ndjekë një model të ngjashëm.

Kjo lëvizje vjen në një kohë kur numri i emigrantëve që kalojnë Kanalin Anglez ka arritur nivele rekord. Vetëm të premten, 51 emigrantë u kapën dhe u zbarkuan në portin e Doverit, një incident që përfshiu edhe një emergjencë mjekësore ku një emigrant humbi jetën.

Ndërkohë, opozita ka kritikuar qeverinë aktuale, me Chris Philp, Sekretari i Brendshëm në hije, që akuzon kryeministrin Keir Starmer se "ka humbur kontrollin e kufijve", duke thënë se Britania kishte mundësi të ishte lidere globale me planin për dërgimin e emigrantëve në Ruandë, por që u anulua nga qeveria laburiste



**Dotech**  
website 

Për çdo konsultim mund të na kontaktoni  
ose mund të vini në zyrat tona

- BUSINESS CARDS
- LOGO
- BANNERS
- POSTERS
- VIDEO MARKETING



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

# ZYBER

**Your one-stop destination for all needs.**

**Smashing prices**

**Super çmime, për më shumë visitoni dyqanet tona!**

Paint mixing in stores 10,000 colours available.

|  |  |  |   |  |   |
|--|--|--|---|--|---|
| <p>Dulux Trade Supermatt White 10L</p>  <p>£33.32<br/>Ex. VAT</p>                     | <p>Dulux Trade Vinyl Matt Pure Brilliant White 7.5L</p>  <p>£25.81<br/>Ex. VAT</p>  | <p>Dulux Trade Vinyl Matt White 10L</p>  <p>£41.65<br/>Ex. VAT</p>                                   | <p>Dulux Trade Diamond Matt Pure Brilliant White 10L</p>  <p>£72.48<br/>Ex. VAT</p>        | <p>Leyland Contract Matt Brilliant White 10L</p>  <p>£18.50<br/>Ex. VAT</p>                                     | <p>Leyland Trade Vinyl Matt Emulsion Brilliant White 10L</p>  <p>£29.98<br/>Ex. VAT</p>                          |
| <p>Leyland Trade Super Leytex Matt Brilliant White 15L</p>  <p>£22.48<br/>Ex. VAT</p> | <p>Leyland Trade Acrylic Eggshell Brilliant White 5L</p>  <p>£30.81<br/>Ex. VAT</p> | <p>Johnstones Trade Jonmat Premium Contract Matt Brilliant White 10 L</p>  <p>£23.75<br/>Ex. VAT</p> | <p>Johnstones Trade Covaplus Vinyl Matt Brilliant White 10L</p>  <p>£29.98<br/>Ex. VAT</p> | <p>Johnstones Trade Covaplus Vinyl Matt Brilliant White 5L</p>  <p>£21.65<br/>Ex. VAT</p>                       | <p>Johnstones Trade Acrylic Eggshell Brilliant White 5L</p>  <p>£38.31<br/>Ex. VAT</p>                           |
| <p>Crown Vinyl Matt White 7.5L</p>  <p>£19.98<br/>Ex. VAT</p>                         | <p>Crown Trade Clean Extreme Matt White 5L</p>  <p>£29.98<br/>Ex. VAT</p>           | <p>Crown Trade Quick Dry Fastflow Satin White 5L</p>  <p>£29.15<br/>Ex. VAT</p>                      | <p>Macpherson Eclipse Emulsion Brilliant White 15L</p>  <p>£21.65<br/>Ex. VAT</p>          | <p>Macpherson Eclipse Matt 15L Magnolia</p>  <p>£21.65<br/>Ex. VAT</p>  | <p>Macpherson Durable Acrylic Matt Brilliant White 5L</p>  <p>£22.48<br/>Ex. VAT</p>                             |
| <p>Macpherson Vinyl Matt Paint Brilliant White 10 L</p>  <p>£20.98<br/>Ex. VAT</p>    | <p>Armstead Trade Contract Matt White 10L</p>  <p>£20.81<br/>Ex. VAT</p>            | <p>Dulux Trade Quick Dry Gloss Pure Brilliant White 5L</p>  <p>£44.15<br/>Ex. VAT</p>                | <p>Dulux Trade Diamond Matt Pure Brilliant White 5L</p>  <p>£34.98<br/>Ex. VAT</p>         | <p>Leyland Acrylic Primer Undercoat White 5L</p>  <p>£24.50<br/>Ex. VAT</p>                                     | <p>Crown Trade Fastflow Quick Dry Gloss White 5L</p>  <p>£28.31<br/>Ex. VAT</p>                                  |
| <p>Dulux Trade Quick Dry Wood Primer Undercoat 5L</p>  <p>£55.81<br/>Ex. VAT</p>      | <p>Zinsser BIN Aqua 2.5L</p>  <p>£49.98<br/>Ex. VAT</p>                             | <p>Gyproc Easifill 60 Filler &amp; Jointing Compound 10Kg</p>  <p>£19.98<br/>Ex. VAT</p>             | <p>Ronseal High Performance Wood Filler, White, 3.7 kg</p>  <p>£33.31<br/>Ex. VAT</p>      | <p>Uniwipe x6 Ultra Grime Ultragrim Industrial Multi-Purpose Cleaning Wipes X100</p>  <p>£49.89<br/>Ex. VAT</p> | <p>Uniwipe X6 Ultragrim Textured Power Scrub Surface Cleaning Hand Wipes X80 Pack</p>  <p>£59.98<br/>Ex. VAT</p> |

## WHY US?

✓ Expert service

✓ Delivery In UK

✓ Open 7 days a week

## FIND US

1342 Greenford Road, Greenford, UB6 0HL

0207 387 5328

168 Kentish Town Rd, Camden Town, NW5 2AG

0207 482 2722

76 Elmers End Road, Beckenham, SE20 7UX

0208 778 4222

49-51 Fulham High Street SW6 3JJ

0207 736 8153

73 Chase Side Southgate London N14 5BU

0208 882 2490

57 Wembley Hill Road, London, HA9 8BE

0204 537 4791

52 Northcote Rd, Clapham, London SW11 1PA

0203 093 1646

Unit 6 Grand Union Trade Park Abbey Road, London, NW10 7UL

[www.zyberltd.co.uk](http://www.zyberltd.co.uk)

ZYBER LTD

zyberltd

zyber.ltd

Zyber Ltd

zyber.ltd

# A DUHET BESUAR HEKURUDHA TIRANË-PRISHTINË?

## LUTFI DERVISHI

Duhet besuar, patjetër!

Duhet besuar sepse në vitin 2011 u paraqit madhërisht plani për 7 linja tramvajesh në Tiranë. Sot? Sot të gjithë po i shijojnë. Po të mos kishim tramet sot çdo banor i kryeqytetit do të harxhonte 2-3 orë në trafik.

Duhet besuar sepse hekurudha Tiranë-Durrës, me degëzim për në Rinas, ka mbaruar me sukses...! Është aq moderne dhe ekologjike sa

nuk dëgjon zhurmën e trenit dhe, madje, as nuk e sheh dot.

Duhet besuar sepse stacioni i ri i trenit në Tiranë është ndërtuar! Po, është supermodern, i tejdukshëm, por vetëm për ata që janë të zgjuar.


Duhet besuar sepse ura Velipojë-Ulqin, me gjithë dimensionin e saj modest prej 300 metrash, u realizua me sukses absolut... në 3D! Madje më shpejt u ndërtua në konferencat për shtyp sesa në terren. Është ura që bashkon dy brigje të imagjinatës, me një karikaturë të realitetit.

Duhet besuar se hekurudha Tiranë-Prishtinë do bëhet, sepse ne jemi vendi ku projektet ecin më shpejt se trenat, pikërisht sepse nuk ka tren.

Duhet besuar sepse:

Stadiumi i Kukësit u premtua si "Camp Nou i Veriut", por doli si fusha e lagjes pas një shiu të lehtë.

Porti i Durrësit do të bëhet më i madhi në Mesdhe... por deri tani ka lundruar vetëm në makete, në intervista dhe në tendera. Njerezit kanë paguar që tani



pse kompania sikur paska fjalimentuar.

Zgjerimi i bulevardit të Tiranës deri te liqeni i Paskuqanit – në realitet është zgjeruar vetëm durimi i banorëve që presin.

Akademia e çobenëve ka mbaruar dhe nuk ka dele që nuk e beson. Prandaj, duhet besuar hekurudha Tiranë-Prishtinë.

Duhet besuar, patjetër! Se ne jemi populli që nuk ecën me tren, por me kismet. Dhe kismetin nuk ka nevojë për shina.

për apartamente, prandaj po ecën aq shpejt.

Teatri i ri Kombëtar do të ngrihej si simbol i kulturës së re por, për momentin, është simbol i asgjësë me kulla që rriten rreth e përqark.

"Air Albania Campus" për studentët – një ëndërr që nuk shuhet kurrë edhe

## FUSHATË TALLJEJE NË REPUBLIKËN E GALLATËS

Kjo fushatë po thyen rekorde! Nuk po flasim për arritje ekonomike, por për shfaqjen më të madhe komike që ky vend ka parë ndonjëherë. Me një aplikim të thjeshtë, kjo fushatë mund të futet fare mirë në listën e trashëgimisë shpirtërore të UNESCO-s! Është fushata e parë pa debat Pse të debatosh kur mund të flasësh në kafe, në Facebook, Instagram apo në ëndërr? Debatet?

Debatet janë për ata që s' kanë pushtet. Për atë që është në pushtet, mjafton monologu! Është një fushatë ku partia që qeveris prej 12 vitesh, kundërshtarit kryesor e quan kënetë, ndërsa veten qelibar.

Një fushatë jo vetëm pa debat, por pa thelb, pa mish, pa kocka, veç me

aromën e ëndrës për një pasaportë që do vijë në vitin 2030, sigurisht me tren!

Një fushatë pa reklama në TV?

Pse të ketë?

Populli e di për kë do votojë! Reklammat janë për produktet që kanë konkurrencë.

Në këtë fushatë Partia në pushtet, e dashuruar me monopolet e PPP-të, i ka dhënë vetes te drejtën ekskluzive për të mos thënë asgjë, për të mos premtuar asgjë, për të mos shpjeguar asgjë. Larg qoftë për llogari e bilanc!

Kryeministri? Ai është në "silent

mode". 15 ditë para ditës së votimit, ai i ngjan yllit të një reality show që nuk ka nevojë të paraqitet në çdo episod. 10 gladiatorë opozitarë përplasen ditë-natë në studio, ndërsa ai, Cezari modern, do të duket në finale, për të marrë trofeun.

Ai nuk ka kohë për dalje në TV, sepse është duke ndjekur sondazhet, që siç dihet, bëhen me metoda të shenjta: lutje, meditim dhe pak magji statistikore. (Siç thoshte Mark Twain, çfarë t'i bëjmë fakteve, por numrat në dorë i kemi).

Është një fushatë ku tallja është

ushqimi bazë. Nuk flitet për shpopulimin, sepse ka mbetur pak popull për të dëgjuar. Flitet për pasaportën se kur të ikin të gjithë, të paktën të ikin me stil, si zotërinj të vërtetë.

Opozita e vjetër është kënetë, opozita e re është moçal, lideri opozitës është buf, ata që votojnë opozitën janë çyryk, ata që nuk shohin mrekullitë e qeverisë janë autik dhe ata që nuk kanë ndërmend të votojnë partinë në pushtet më mirë të rrinë në shtëpi!

Është një fushatë ku në vend të pro-

gramit, ka diss-e.

Në vend të platformës, ka batuta.

Në vend të projekteve, ka një dron me pankartë: "2030!"

Dhe në fund, mbi të gjitha, kemi valle.

Kjo është fushata jonë: pa debat, pa thelb, por me shumë gallatë.

Një vend që qesh, sepse nuk qan dot.

Kjo është Republika e Gallatës, ku zgjedhjet nuk janë për të zgjedhur, ku kush flet humb, kush hesht fiton dhe kush tallet sundon.

LUTFI DERVISHI

# Dotech

website

“ AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ? ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545



The Albanian

MAL BERISHA

# BUSTI I SKËNDERBEUT NË LONDËR I LËNË NË NJË GJENDJE SA QË BËN TË SKUQET ÇDO SHQIPTARO-BRITANIK

Kur, më 28 nëntor 2012 – në 100-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë e vendosëm bustin e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, në zemër të Londrës, e festuam atë ngjarje me krenari dhe gëzim të rrallë.

Derisa shërbeja si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, u përkujdesa personalisht për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e këtij monumenti.

Kujdesesha që piedestali të ishte i pastër, që mjedisi përreth të ishte i gjelbëruar, i dekoruar me lule të çdo stine, dhe i mbrojtur nga çdo akt vandalizmi pasi aty cenohet vetë nderi ynë kombëtar.

Këto ditë, mbesa ime Andra Berisha dhe nipi im Skai Berisha së bashku me prindërit e tyre, Erionin dhe Kreuzen, vizituan me kërshtëri dhe krenari atë monument. Por çfarë gjetën aty? Një pamje të zymtë e zhgënjyese:

Mjedisi përreth i lënë në harresë, i papastër, i xhveshur dhe aspak i denjë për figurën që përfaqëson.

Një shëmti që nuk mund të imagjinohet pranë asnjë monumenti në një qytet si Londra – Galeria e Artit



Skulpturor me fame botërore.

Nuk dua të hyj në komente më të thelluara, për të shmangur çdo keqkuptim apo perceptim të ndonjë konflikti interesi pasi qeveria shqiptare, pra Ministria e Kultures, nuk e likujdoj financiarisht asnjehere ate veper monumentale. Por nuk mund të hesht.

Ku janë institucionet e shtetit shqiptar?

Ku janë shoqatat shqiptaro-britanike, që dikur krenoheshin me këtë veper monumentale?

Një monument i tillë, që përfaqëson

dinjtetin tonë kombëtar dhe historinë tone më të lavdishme, nuk mund te lihet në këtë gjendje. Kujdesi për të është detyrë dhe obligim zyrtar, moral dhe kombëtar.

Është shumë e lehtë të shpalesh veten patriot me fjalë.

Por vetëm kush vepron, meriton të

quhet i tillë.

Ju lutem, shihni dhe krahasoni këto dy fotografi të monumentit në fjalë – 28 nëntor 2012 – Dita e inagurimit, – 1 Nëntor 2015 – Dita e largimit nga Londra, – 12 Prill 2025.....! Proud to be Albanian!? Apo jo!?



Explore our great range of styles to discover yours

What's your type? Our collection has something for everyone. Refreshed retro looks, sharp geometrics, loud and clear transparents, a range of bold colours, and subtle, understated styles. Our experts can help you choose, and together we'll find the pair for you.



Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani zhvilloi një vizitë pune në Londër në institucionet e drejtësisë, që merren me inspektimin dhe procesin disiplinor të magistratëve dhe në Ministrinë e Jashtme britanike.

Metani u shoqërua nga një ekip i ILD-së dhe nga ambasadori i Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, Uran Ferizi.

Në Inspektoratin e Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës së Madhërisë së Tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë u mikprit nga Kryeinspektori, Anthony Rogers.

Të dy bashkëbiseduesit u ndalën në ndarjen e praktikave të mira mes institucioneve dhe rolin që ka procesi i inspektimeve në eficientë e sistemit të drejtësisë për promovimin e transparencës e paanësisë, në shërbim të besimit të publikut.

Më tej, Metani dhe delegacioni që e shoqëronte zhvilluan sesione pune me ekipin e Inspektoratit britanik të Prokurorisë. Zëvendës Kryeinspektoria, Lisa Morris bëri prezantimin e Inspektoratit e Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës. Procesi i inspek-

timeve, inspektimet tematike dhe inspektimet pasuese u paraqitën nga Inspektori i Lartë ligjor, Colin Darroch dhe nga Inspektoria ligjore, Leanne Townsend.

Rekomandimet dhe impakti i inspektimeve u trajtua nga z.Rogers dhe znj.Morris, duke iu përgjigjur interesit të ekipit të ILD-së për aspekte të punës dhe krahasim me modelin e Shqipërisë.

Në takimin e zhvilluar në Zyrën e Hetimeve të Sjelljes Gjyqësore ekipi i ILD-së u njoh nga drejtuesi operativ Simon Parsons dhe shefja e çështjeve pranë kësaj zyre, Kim Webb me të gjitha aspektet e punës mbi hetimin e

## "FORMULA" BRITANIKE PËR HETIMIN E MAGJISTRATËVE, METANI NË LONDËR



sjelljeve të gjyqtarëve britanikë për llogari të Ministrit të Drejtësisë dhe Drejtueses së gjyqësorit në Mbretërinë e Bashkuar.

Ngjashmëritë në procesin e hetimit disiplinor, llojet e shkeljeve disiplinore dhe masat ndëshkuese ndaj gjyqtarëve u trajtuan gjerësisht gjatë takimit nga Inspektori i Lartë i Drejtë-

sisë, Metani dhe Parson e Webb nga Zyra e Hetimeve të Sjelljes Gjyqësore.

Pjesë e vizitës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në Londër ishte edhe një takim në Ministrinë e Jashtme britanike, me drejtoren për Ballkanin Perëndinor, Madeline Knox. Pasi i bëri një prezantim të funksioneve e rolit të ILD-së në sistemin e drejtësisë, Metani vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të Mbretërisë së Bashkuar për shtetin e së drejtës dhe integrimin evropian të Shqipërisë.


Knox vërejtë se marrëdhënia me Shqipërinë është shumë e rëndësishme për Mbretërinë e Bashkuar, që ka investuar për këtë ssepse e kon-

sideron një partneritet të rëndësishëm edhe për të ardhmen.

Metani dhe Knox bashkëndanë qëndrimin e përparimit të Shqipërisë në fusha prioritare siç është lufta kundër korrupsionit, shteti i së drejtës dhe besimi i publikut tek sistemi i drejtësisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani dhe delegacioni i ILD-së u mikpritën në ambasadën e Shqipërisë në Londër nga ambasadori, Uran Ferizi.

Pasi falenderoi ambasadorin për mbështetjen në organizimin e kësaj vizite, Metani u informua nga Ferizi mbi punën e Ambasadës sonë në mbrojtje të interesave të Shqipërisë e shqiptarëve që jetojnë në Mbretërinë e Bashkuar, si dhe kontributin britanik për përparimin e vendit tonë.



### ENVER ROBELLI

Kur vizitoi Shqipërinë në vitin 2014, Papa Françesku iu drejtua botës me dy mesazhe. "Të vrasësh në emër të Zotit është sakrilegj i madh", tha ai. Me këto fjalë kreu i Kishës Katolike dënoi terrorizmin e fanatikëve islamikë, sidomos në Siri.

Mesazhi i dytë ishte ky: Shqipëria, sipas Papës, "mund të bëhet një shembull për shumë vende" për shkak të modelit të bashkëjetesës mes myslimanëve, katolikëve dhe ortodoksëve. Vizita e tij ishte e para në një shtet evropian pas zgjedhjes në postin më të lartë të Kishës Katolike.

Françesku ishte një Papë i pazakonshëm. "Sa i përket vdekjes sime, kam një qëndrim mjaft pragmatik. Gjithçka është gati", kishte thënë ai. Të hënën në orën 07:35 Vatikani publikoi lajmin për vdekjen e tij: Zëvendësi i Krishtit "u kthye në shtëpinë e Zotit". Me gjasë ishte një puqje mes ligjeve hyjnore dhe atyre tokësore: të largohesh nga kjo botë të hënën e Pashkëve nuk ia arrin çdo Papë. As secili nga 1.4 miliardë kato-

## NJË PAPË KUNDËR POMPOZITETIT

likët e kësaj bote.

I pazakonshëm ishte Françesku, sepse nuk ishte i dhënë pas luksit dhe pompozitetit. Paraardhësi i tij, Benedikti i XVI, binte në sy jo vetëm të fotografëve me këpucët e tij të kuqe papnore. "Karnavali mori fund", citohe të ketë thënë Françesku kur pas zgjedhjes zyrtarët e Vatikanit tentuan ta stolisnin. Françesku u përpoq të mbesë njeri afër popullit. Pasi u zgjodh Papë, i telefonoi shitësit të gazetave në Buenos Aires për ta informuar se nuk mund t'ia dërgonte më gazetën në adresën e njohur në kryeqytetin argjentinas. "Ti e di se çfarë ka ndodhur". Ajo që kishte ndodhur ishte paksa revolucionare: Jorge Mario Bergoglio, i rritur në Flores, një lagje e Buenos Airesit, ishte Papa i parë që nuk vinte nga Evropa.

Për një Papë, biografia e tij ishte spektakolare. Ishte adhurues i madh i futbollit, anëtar i klubit të futbollit Atlético San Lorenzo de Almagro (Buenos Aires). Para se t'i përkushtohet tërësisht shërbimit ndaj Zotit, ai kishte punuar pastrues në një fabrikë çorapësh dhe rojtar në një klub nate. "Kam pasur një të dashur, një vajzë të ëmbël", do të tregonte më vonë nga roli i tij i Papës, ndërsa fliste për vitet e hershme të rinisë, kur ende s'ishte përcaktuar për rrugën kishtarë. E ëma e tij dëshironte që ai të studionte mjekësi. "Nuk të kam gënjer. Po studioj mjekësi. Mjekësinë e shpirttrave", iu përgjigj ai një ditë.

Kur u bë Papë, zgjodhi emrin

Françesk si shenjë nderimi ndaj Françeskut të Asizit, një murg lypsar, i cili më 1206 dëgjoi zërin e Jezusit: "Françesko, shko dhe ndërto sërish shtëpinë time, e cila, siç e sheh, është krejt e rrënuar".

Në Vatikan Papa argjentinas nuk pranoi të udhëtojë me veturë të shtrenjtë. Mori një "Renault 4", prodhim i viteve 1980. Jo secilit kardinal i pëlqente që Papa hiqte dorë prej çdo salltaneti që sjell ky post. Disa e etiketonin edhe si komunist apo marksist. Ai ishte kritik i kapitalizimit të shfrenuar. "Kjo ekonomi vret", shkroi ai duke folur për eksetet në botën e financave - dhe kësaj u bë hero i shumë kritikëve të globalizimit pa rregulla.

Në Argentinë Bergoglio ishte adhurues dhe mbështetës i teologjisë së çlirimit. Kur u zgjodh Papë, disa e akuzuan se nuk i kishte mbrojtur viktimat e diktaturës ushtarake argjentinas. Teologu prominent Leonardo Boff tha: "Ai ka shpëtuar dhe fshehur shumë njerëz, të cilët përndiqeshin nga diktatura ushtarake".

Kardinali sloven, Franc Rode, njëri nga krahu konservator i Kishës Katolike, e komentoi zgjedhjen e Françeskut me këto fjalë: "Do të jetë katastrofë". Ai e dinte se Bergoglio kishte aversion ndaj strukturave të ngurta të Kishës Katolike, ndaj korrupsionit në radhët e saj, ndaj keqpërdorimeve të shumta. Kardinalët i akuzoi se vuajnë nga Alzheimeri mendor, se mendojnë që janë "të pavdekshëm", "të pazëvendësueshëm", se

kanë "zemër prej guri", se janë të izoluar në "narcizëm dhe krekosje".

Ky Papë nuk e kalonte gjithë kohën nëpër paragrafë, ultësira teorike dhe interpretime biblike. Të tillë ka shumë në Kishën Katolike. Dhe të tillët e nënçmonin argjentinasin duke aluduar se s'ishte intelektual. Kjo nuk ishte e vërtetë. Ai kishte studiuar filozofi e teologji, adhuronte dhe njihje mirë muzikën klasike, lexonte klasikët rusë dhe gjermanë.

Si asnjë Papë tjetër ai apeloj që njerëzit të mbrojnë ambientin. "Kush jam unë të gjykoj", tha ai spontanisht duke folur për homoseksualët. Por edhe në këtë çështje ai mbrojti mendimin kishtar se "homoseksualizmi është mëkat". Nuk pranoi që gratë të ushtrorin funksionin e priftëreshave, por gjatë pontifikatit të tij ai avancoi shumë gra në pozita të rëndësishme në Vatikan, reformoi (pastroi) bankën e Vatikanit, ndaloi bizneset e kishës me mafien, ashpërsol ligjet kundër keqpërdorimeve të mëdha seksuale nga ana e dinjitarëve kishtarë. Këto keqpërdorime kanë luajtur një rol të madh në largimin e shumë njerëzve nga Kisha Katolike.

Për Papa Françeskun ishte me rëndësi dialogu me krerët e feve apo konfesioneve të tjera. Në Abu-Dabi nënshkroi një deklaratë me Ahmad al-Tajebin, një prijës i myslimanëve sunitë. U takua më 2016 në Kubë me Kirilin I të Kishës Ruse. Papa Françesku u përpoq të ndërmjetësonte në luftën në Ukrainë, por jo përherë e

gjeti tonin e duhur. Për këtë u kritikua ngase, sipas kritikëve, nuk e mbështeti pa ekuivokë Ukrainën. Në konfliktin në Lindjen e Afërt, Papa Françesku kritikoi ashpër si sulmet terroriste të Hamasit, por edhe luftën e Izraelit në Gaza. Porosia e tij ishte: Kisha është "spital fushor" për të shëruar shpirtat e njerëzve.

Një rregull i pashkruar thotë se pas një Pape të afërt me popullin, kardinalët zgjedhin një Papë konservator. Në Vatikan tashmë qarkullojnë shumë emra. Njërin prej tyre do ta zgjedhë konklava në javët e ardhshme.

Një herë agjendën do ta dominojnë ceremonitë e varrimit të Papës. Dëshirë e tij ishte të varrosset si çdo kristian, pa shkëlqim e madhësi të tepruar.

Në atdheun e tij, në Argentinë, është shpallur zi shtatëditore. Por marrëdhëniet e tij me presidentin populist, Javier Milei, kanë qenë të tensionuara. Në fushatën elektorale të vitit 2023 Milei e ofendoj Papën duke e quajtur "përfaqësues të së keqes mbi tokë" dhe "idiot që mbron drejtësinë sociale". Të gjitha këto Papa ia fali kur Milei erdhi për vizitë në Vatikan, tashmë si presidenti i Argentinës.

Jorge Mario Bergoglio ishte njeri zemërgjerë në një botë që gjithnjë e më shumë po dominohet nga cinikët, populistët dhe mizantropët. Këta i falte dhe i injoronte, ndërsa për të rinjtë kishte këtë porosi: "Bëni tollovi". koha

**TRANSPORT  
APOLLONIA**



**TRANSPORT  
MAKINASH  
ANGLI-SHQIPËRI**

**00447429200952**

**OFRON SHERBIME TRANSPORTI  
MAKINA  
MOTORCIKLETA  
PJESË MAKINASH  
MAKINERI BUJQËSORE  
MOBILJE  
FASADA XHAMI  
DYER & DRITARE, MOBILIERI ETJ**



**00355682948843**

**00355694031009**

**00447429200952**

**TRANSPORT MALLRASH  
ANGLI-SHQIPËRI  
SHQIPËRI-ANGLI**



[www.transportapollonia.co.uk](http://www.transportapollonia.co.uk)



# #BreakingTheChains

## Forest Gate Youth Club

Immigration advise

Sports & Dancing

Peer support

General info and support


Come Dine with Me



Join us


every Monday evening 6-9pm

 1 Woodford Road,  
Forest Gate,  
London, E7 0DH

 07494974957

  
**Shpresa Programme**

Inspiring hope & change



# SHISHA BAR PËR SHITJE

- I HAPUR PREJ VITESH
- ME KLIENTELE TË GARANTUAR
- I PAJISUR ME TE GJITHA LIÇENSAT
- ÇMIMI SHUMË I ARSYESHËM
- PËR MË SHUMË INFO NA KONTAKTONI
- TEL: 07557565437



ARTAN HOXHA

# 12 DËSHTIME NË 12 VITE

Rilindja po plotëson 12 vite në qeverisje, 8 prej të cilave e vetme në timon, ndërsa po kërkon një tjetër mandat 4 vjeçar duke shmangur llogaridhënien për bilancin e shkuar e duke shpërqendruar vëmendjen përmes premtimit të anëtarësimit të përshpejtuar në Bashkimin Europian në vitin 2030-divulguar përmes metaforës së pasaportës europiane nga vetë Kryeministri.

Në fakt, 12 vite qeverisje rilindëse shënojnë 12 dështime të mëdha dhe/ose premtime të pambajtura.

Shëndetësia falas jo vetëm që është bërë shumë më e shtrenjtë por është bërë shëndetësi që edhe nuk shëron edhe që poshtëron. Shqipëria, ndër vendet me rritjen më të lartë të vdekjeve shtesë nga Covid19 në rang europian e botëror, me numrin tejet të ulët të mjekëve e infermierëve për frymë, me koncesionet abuzive e deri tek skandali i pashpirt me ilaçet e mohuara për pacientët fatkeq tek Spitali Onkologjik janë ndër provat më domethënëse të këtij dështimi.

Premtimi për ujë të pijshëm 24 orë, në fakt me rritje veçse modeste të orëve mesatare të furnizimit, pa rritje të cilësisë (mbetet si gjithnjë ujë për larje lëvresësh, pjatash e dyshemersh) dhe asnjë shtesë domethënëse në trajtimin e ujërave të zeza, ndonëse në sektor janë investuar shuma marramendëse dhe borxhet e sektorit për energjinë dhe furnizuesit e tjerë janë rritur eksponencialisht, është një tjetër premtim i pambajtur dhe dështim i paralajmëruar.

Arsimi, premtuar të financohet me 5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), mezi arrin 2.5% ndërsa Testi Pisa dëshmon rënien në pikatë të cilësisë së dijenxënies si treguesi më sintetik i gjithë morisë së problemeve e mangësive në dimensionet horizontale e vertikale të sistemit arsimor e të relacioneve të tij me shtetin partiak, shoqërinë në emigrim e plakje, dhe ekonominë në koncentrim e drogëzim, një tjetër dështim rilindës por me pasojë afatgjatë.

Bujqësia dhe agroindustria, e premtuar se do rilindte me qeverisjen e tyre, po shkon drejt vdekjes klinike nga konkurrenca e pamëshirshme e importit, pakësimi i fuqisë punëtore e rinore në fshat prej emigrimit masiv dhe zhvendosjes së përshpejtuar drejt qyteteve, subvencionet klienteliste dhe investimet e pakta shtetërore në infrastrukturën bujqësore e rurale e deri tek bllokimi i fondeve të Bashkimit Europian, IPARD III, si pasojë e abuzimeve me fondet e fazave të mëparshme.

Pastrimi i Shqipërisë nga plehrat, krenaria e Kryeministrit, rezultoi në dështimin më spektakolar të Rilindjes. Kosto qindra milion euro drejtpërdrejt e lidhur me inceneratorët inekzistentë dhe/ose jofunksionalë është vetëm maja e ajsbergut të dëmeve. Ndryshimi i skemës, kapërcimi i fazave të ripërdorimit dhe



riciklimit, grumbullimi i përqendruar e me përdhunë i mbetjeve për qëllimet e skemave abuzive të incenerimit shkatërroi industrinë e ricikluesë dhe gjithë rrjetin e grumbullimit e të seleksionimit paraprak ndërsa ekonomia humbi vlerat kolosale të këtyre lëndëve të para kaq të çmuara.

Industria përpunuese dhe eksportet përkatëse në rënie vijuese prej disa tremujoresh tashmë, pasojë e drejtpërdrejtë e narkoeverësive që fuqizojnë virtualisht lekun dhe tërheqin kapitale në sektorët ku pastrohet më kollaj origjina kriminale e parasë, siç është ndërtimi masiv i banesave e kullave, e gjitha kjo falë bashkëqeverisjes së Rilindjes me Krimin e Organizuar. Në industrinë minerare dhe atë energjetike asnjë shtesë domethënëse kapacitetesh prodhuese përveç premtimeve karagjozë për naftën e Shpiragut dhe hidrogjenin e Bulqizës që do na ushqenin me lugë floriri, siç Norvegjezët nafta e Detit të Veriut.

Infrastruktura rrugore, premtuar se do ndërtohej e plotë, e shtirë në territor në shërbim të zhvillimit dhe me standarde europiane sot është në pikë të hallit. Në 12 vite Rilindja nuk ka bërë dot as gjysmën e kilometrave rrugë kombëtare krahasimisht qeverisjes demokrate në 8 vite, edhe këto vende të pambaruara, me kosto të shumëfishuara e kohëzgjatje tërkuzë; për rrugët rurale as që është kujtuar kush nga rilindja e ato që la të bëra qeveria e mëparshme janë dëmtuar; rrugët përshkuese të zonave industriale janë ku thërret qameti, sa për ilustrim: rrjeti rrugor përshkues i shpartalluar tërësisht në zonën industriale në dy krahët e superstradës Tiranë-Durrës, zonë kjo që jep më shumë se gjysmën e PBB-së e të taksave. Në 12 vite kjo qeveri mezi mbaroi gjysmën tjetër të Unazës së Tiranës ndërsa të hysh e të dalësh prej saj është një tmerr i vërtetë.

Cilësia e mjedisit, ajrit, ujërave, py-

jeve, tokës dhe erozionit të saj, premtuar se do përmirësohej thelbësisht, është përkeqësuar në vijimësi e pakthim. Pa trajtim të ujërave të zeza, me një pjesë të madhe të mbetjeve urbane e industriale që përfundojnë në lumenj e prej këtu në det, bashkë me tretjet e pesticideve e kimikateve të mbipërdorura në bujqësi, po shkatërrohet flora dhe fauna detare si dhe cilësia e ujërave në plazhe në dëm të turizmit bregdetar. Pyjet në pakësim, po kështu lulishtet e parqet në qytete (përveç gënjeshtrave me 1 milion pemë në Tiranë) ndërsa galopi i ndërtimit dhe zvarritja e trafikut, veçanërisht në qytetet e mëdha dhe rrugët në bregdet, kanë rritur ndjeshëm ndotjen e ajrit. Shqipëria pozicionohet ndër vendet më të ndotura të Europës në disa tregues thelbësore mjedisorë, e shëndetësorë për rrjedhojë.

Ndërsa të ardhurat për fryme mezi arriten 1/3 e mesatares së Bashkimit Europian pabarazia, premtuar nga rilindja se do zbutej, është thelluar dhe ashpëruar. Rilindësit kritikojnë qeverisjen demokrate me argumentin se 5% e depozituesve posedonin gjysmën e vlerës së depozitave bankare në 2012-tën dhe ata do ta përmbysnin këtë realitet me politikën e tyre sociale dhe taksën progresive, por sot, më pak se 5% e depozituesve zotërojnë afro 60% të totalit të vlerës së depozitave bankare. Nëse këtu konsiderojmë edhe llojet e tjera të pasurive, më se pari ato imobiliare, pabarazia thellohet e ashpërsohet edhe më shumë.

Ndërsa premtuan barazi e drejtësi sociale dhe shanse të barabarta, raporti me pushtetin rilindës është bërë burim parësor i pabarazisë, padrejtësisë dhe diferencimit social si për individët edhe për bizneset. Kontraktimi shtetëror, prokurime e koncesione, është tashmë një sistem i fuqishëm dhe efektiv i shpërndarjes preferenciale e korruptive të përfitimeve ekonomike kundrejt mbështetjes dhe besnikërisë politike. Punësimi në

shtet, pa meritokraci dhe i shtuar në numër me mbi 20 mijë vetë (shtesë prej afro 13% ndërsa popullsia zvogëlohet me 16% dhe koncentrohet në qytete ndërsa rritet përdorimi i teknologjisë IT dhe IA në administrimin publik), është bërë streha e patronazhimit të votës. Nga sondazhet elektorale të Euronews dhe News24 rezultojnë se votuesit e Rilindjes që e vlerësojnë pozitivisht gjendjen aktuale ekonomike dhe atë të pritshme të familjeve të tyre përbëjnë shumicën e atij elektorati, tregues ky 2-4 herë më i lartë se tek votuesit demokratë apo ata neutralë.

Rilindësit e përdornin emigrimin si argument të qeverisjes së keqe të demokratëve por emigrimi gjatë qeverisjes rilindëse rimori përmasa eksodit. Census 2023, i zvarritur dhe i trukuar, nuk e fshih dot degradimin demografik. Shqipëria ka humbur rini, moshë pune dhe moshë pjellore me ritme të paktën dy herë më të larta emigratore gjatë 12 vjeçarit rilindës krahasuar me dekadën e mëparshme dhe ky ritëm ka qenë 4-5 herë më i lartë në 6 nga 12 vitet rilindëse, veçanërisht këto 3 vitet pas pandemisë Covid19. Emigracioni s'ka se si të mos këtë qenë fortësisht asimetrik edhe politikisht, për shkak të pabarazisë ekonomike e sociale që ka krijuar pushteti afatgjatë i Rilindjes.

Rilindja premtoi rend e drejtësi por përfundoi me polici të inkriminuar deri në palcë dhe drejtësi të politizuar deri në rrënjë. Simbioza Rilindje-Krim i Organizuar kaloi në katër faza: përfshirje e drejtpërdrejtë në parlament dhe pozita të tjera shtetërore te eksponentëve të krimin të organizuar që në 2013; kanabizim në 2016 përpara zgjedhjeve 2017; ngritje e krimin të organizuar shqiptar në nivelin e trafikut ndërkombëtar të kokainës para zgjedhjeve 2021; pastrimi në vlera gjigante e parasë së drogës në

ekonominë shqiptare, veçanërisht në ndërtim, përpara zgjedhjeve 2025. Publikimet e bisedave në rrjetet e inkriminuara, ardhur nga Franca a Belgjika e demonstrojnë më së miri lidhjen rilindje-polici-prokurori/gjykatë-krim i organizuar.

I vetmi përfitim (i përkohshëm) i këtij sistemi miks narko-shtet është rënia e krimeve ordinere, që si rregull bien në kësi sistemesh, rënie në të cilën ka kontribuar edhe emigracioni. Në ndërkohë, drejtësia rilindëse ka akumuluar mbi 150 mijë dosje në pritje për trajtim nga më pak se 35 mijë në 2015, e sot, një vendim gjyqësor i formës së prerë mund të kërkojë edhe në shumë se një dekadë-imagjinohet fare lehtë se sa është rritur çmimi i korruptionit në këtë farë drejtësie. E, sa për fundin e pandëshkueshmërisë, gjethja e fikut e dashnorë(e)ve të SPAKU-t, po, po, ajo ka përfunduar për këdo përveç për njërin-Kryeministrin. Opozita ndëshkohet padrejtësisht që të fuqizohet pushteti i Kryeministrit, edhe disa qeveritarë krah tij, ata që kanë mullë e dardha prapa shpinës së Kryeministrit, ndëshkohen me lejen paraprake të tij, sepse pushteti i fuqizuar i 1-shit duke dobësuar opozitën ka nevojë edhe të lucidohet nga njollat sipërfaqësore e të legjitimohet kësisoj duke dënuar ca nga të vetët. Afërmendsh që 12 dështimet e mësipërme rilindëse (ka dhe plot të tjera) nuk premtojnë as zhvillim kombëtar as integrim europian, por që gënjeshtra të besohet, ajo duhet të jetë sa më e madhe, sa më e pacipë, sa më pretenduese.

Kryeministri thotë se do përfundojë në kohë rekord negociatat duke përdorur Inteligjencën Artificiale në përafrimin e legjislacionit tonë me atë të Bashkimit Europian (krahas përdorimit magjik të AI në prokurimet publike, e-albania etj).

**FOR SALE**

**PER SHITJE**

**Restorant per shitje ne Londer  
I hapur prej vitesh me klientele te  
garantuar  
I pajisur me te gjitha liçensat  
Ambient fantastik per te gjitha llojet e  
festestave tuaja mbremje, ditelindje,  
fejesa, martesë deri ne 230 veta  
Çmimi shumë i arsyeshëm  
Për më shumë info ju lutem na  
kontaktoni Tel: 07414 828424**



**07414 828424**

## NDUE DEDAJ

Është e habitshme se si shprehja “Nuk ka opozitë” shqiptohet me lehtësi dhe pa kurrëfarë sensi nga individë të ndryshëm, kinse të paangazhuar politikisht, çka nuk e thotë as vetë mazhoranca në mënyrë kaq brutale. Opozitë ka dhe sikur të ekzistojë goftë dhe vetëm një opozitar, jo më një pa-fundësi njerëzish me bindje të djathta, të qendrës, apo nga zona gri, përfshi dhe jo pak individë nga e majta, që dinë me qenë realistë e kritikë ndaj qeverisjes, pa qenë opozitarë në kuptimin klasik të kësaj fjale. Opozita është një realitet demokratik dhe institucional qysh nga viti 1990, kur u krijua partia e parë opozitare, PD, që u pasua nga disa të tjera, pavarësisht problematikave të saj aspak të lehta. Por ato janë çështje të brendshme që i zgjidh vetë ajo dhe asesi kritizimet cmirëzinj nga jashtë, duke e gjuajtur me gurë nga bunkerët ideologjikë të komunizmit të “pavdekshëm”. Vetëm në Shqipëri ndodh të sulmohet opozita, me diskursin dhe vokabularin e pushtetit gjithë bërllok denigrues. Doemos që kjo ka shpjegimin e saj, paçka shtirjes të shumëkujt si i “paprëzier” me politikën. Shprehja vulgare “Nuk ka opozitë” i ka rrënjët në bolshevizmin kronik, nga fillimet e shekullit XX, ndonëse e “freskët” si atëherë në mendjet e mykura dhe pas njëqind vjetësh, nga etërit të bijtë e nipërit. Është mendësi e rrënjësor thellë nga lufta e klasave, për ta parë kundërshtarin politik si armik të për-betuar, jo se pushtetarët kanë ndonjë urrejtje “gjenetike” ndaj palës tjetër, porse pushteti është aq i lakmueshëm për ta dhe nuk duan ta lëshojnë asnjëherë. Ata thonë se e duan këtë gjë

# SHPREHJA “NUK KA OPOZITË”, SINDROMË BOLSHEVIKE

për ta bërë Shqipërinë si Europa, por rezultoni kundërta, pushteti iu nevojitet për të krijuar “bankën” e tyre të përfitimit të paligjshëm nga paratë e tak-sapaguesve.

**Si ka mundësi që nuk paska opozitë?**

Opozitë ka pasur dhe kur kjo mazhorancë ishte në opozitë! E nuk ka si të mos ketë sot, pas tre mandatesh që ajo ka në qeverisje, me afera korruptive të pashembullta e të panumërta, që duhej ta bënte PS-në shumë më pak “vëzulluese” në këtë fushatë. Sa për llogaridhënien, mos o Zot, ajo shihet absolutisht si diçka “anakronike”, mjaft ta shkundim popullin duke e kacarruar si në dasmë.

Opozita ka histori tek ne. Toka e saj nuk është djerr. Opozitë properëndimore ka pasur dhe në vitin e largët 1946, kur u pushkatuan një numër i madh deputetësh, nga elita kombëtare e vendit. Prej asokohe, kur opozita politike u mbyt në gjak, ajo vazhdoi të qëndronte e tillë në burgjet politike për 45 vjet. Opozitë ka pasur dhe në periudhën para dhe gjatë Mbretërisë Shqiptare. Opozita është vlera më e madhe politike e këtij kombi, më shumë se qeverisja. Jo rastësisht krenohemi me figurat



porse tashmë është tjetërkush që i vë pikat mbi i, votuesi i gjërë aspak emocional dhe militant. Fakti që një varg i gjatë partish politike, pavarësisht peshës elektorale të disave prej tyre, janë rreshtuar në një koalicion zgjedhor kryesor, krahas disa grupimeve apo subjekteve të tjera elektorale të djathta ose jo, dëshmon veçse praninë e fortë opozitare.

Nuk ka kurrëfarë logjike dhe morali t'i tregosh opozitës muskujt e pushtetit, t'i bësh karshillëk e aq më tepër t'i bësh “gjqin” me stil bolshevik, për atë çka ajo ka qenë para 12 vitesh në pushtet!? Se ka një handikap të madh në këtë mes, drejtësia e pavarur po u bën gjyqin real figurave qeverisëse të mazhorancës, ministra e kryebashkiakë, ndërsa kjo e fundit nuk tregon ujkun, por gjurmën?!...

Nuk ka as baballarë e as shpëtimtarë të vetëshpallur të kombit. Nuk e ha kush më demagogjinë në kohën e sotme, sado e lubrifikuat të jetë. Në këtë kontekst, opozitës, si e papërlyer që është, i bie të jetë misionare. Zgjedhësi nuk mund të manipulohet nga asnjë lloji propagande prej xhentelmenësh me atlete të bardha a këpucë të kuqe. Ai sheh e shkruan përditë pakënaqësitë nga qeverisja jo e denjë. Ashtu siç është

qytetari që di se kur shkon në BE dhe me cilin lidhshpë politik. Pse themi qytetari? Aspak për të zvogëluar rëndësinë e qeverisjes, porse qytetari shqiptar është integruar me kohë në jetën perëndimore, euro-atlantike, edhe kur qeverisja këtu ka mbetur duke bërë “detyrat e shtëpisë”, siç vetë thotë ajo, nga viti në vit. Qeveria vetëm tani e zbuloi mërgatën shqiptare në botë, u takua përmallshëm me të dhe fort mirë që shkoi më në fund atje, tash të presim dhe votën e saj, që për mendimin tonë do të ketë një peshë specifike në votimet e 11 majit në kahjen e ndryshimit. Kjo kategori gojëprishurish, që shfryn si qëmoti ndaj opozitës, që ka guxim ta bëjë të paqenë atë, duke e “asgjësuar” me një fjalë goje si flakë kashte, kot që përpigjet të na bindë për mosekzistencën e aksionit opozitar, pasi është krejtësisht e pabesueshme, ngaqë ka 35 vjet që këndon të njëjtën këngë “zije”, duke harruar se po të ishte kështu, do të kishte marrë fund vetë pluralizmi politik. Opozita nuk ka nevojë për asgjë që nuk i bën nder opozitarizmit. Asaj nuk i duhet as lëmosha e as arroganca, i mjafton vetvetja dhe fjala e sovranit, që është e vetmja “perëndi” mbi tokë.

Këto pak radhë nuk janë ndonjë “apologji” për opozitën, pasi po të ishte ashtu, do të na duhej një cikël shkrimesh kritike që nuk do të mbaronin as me 11 maj, por thjesht një si “tërheqje vëmendje” për ata individë, jo pak prej tyre miq tanë, të cilët mund ta mbështesin mazhorancën hapur dhe jo me klishe të tilla të dala boje.

Më mirë patronazhistë të shkruar, se të pashkruar.

## ILIR KALEMAJ

Fushata e radhës po shkon drejt fundit. Në shumëçka e ngjashme me paraardhëset. Po aq edhe e ndryshme. Retorika politike e partisë në pushtet shpesh i ngjan asfaltit elektoral të rrugicave shtruar me shpejtësi dhe

shkel e shko. Ngjashëm buçimat e kandidatëve dhe doppelganger-at e tyre. Dajret dhe çingjjet nuk i kanë munguar as kësaj here turbo-politikës të udhëhequr nga kryeministri me atlete. Se çitjanet duken elementi i munguar dhe ndoshta disi rishtar në këtë fushatë pa fantazi.

Ndërkohë oferta politike sjell disa pak risi në kostume, fytyra dhe personalitete të reja, por e ngjashme në strukturë ndonëse opozita ka ditur të sjellë një fryme inovacioni me fushatën e konceptuar nga La Civita.

Por ka edhe ndryshime. Shpesh në kahun e kundërt me atë që konsiderohet progres. Një të huaji do i bënte përshtypje thujse mungesa e posterave të kandidatëve. Zëvendësuar dhunshëm me shefat politikë. Një fushatë që i ngjan më tepër një

## VOTA, EUROPA DHE RROTA

referendumi politik. Me premtime për dyfishim rrogash në administratë dhe 5-10 mijë lekëshin e lëmoshës për pensionistët në vend të rritjes së pensioneve. Por edhe kaq boll e kanë se votën dinë ku ta shkundin partizançe. Me veteranët që kanë thyer dhe çdo ligj biologjik dhe sa vijnë e shtohen ndërkohë që vitet ikin tutje.

Por edhe pala tjetër i kundërpërgjigjet po me premtime tipike për zgjedhje parlamentare. Për ulje taksash dhe mbështetje për familjet e reja. Për inkurajim të profesionistëve që të qëndrojnë në atdhe e të tjera si këto. Ndonëse duhet ende prituri nëse do të ketë rotacion pushteti për t'u materializuar.

Kjo fushatë tregon edhe një lloj lodhje. Është fillimi i fundit të mitingjeve dhe takimeve masive. Takimet derë më derë, më tepër me kameraman pas dhe me kaseta të kurara dhe depozituara me kujdes televizioneve për ta shumëfishuar efektin e një takimi dhe ulur në maksimum

kostot. Fushatë pa shumë reklama televizive dhe e mbushur me monologje të mërzitshme, deri në bezdi të kandidatëve. Të cilët duke qenë se refuzojnë të dalin përballë njëri-tjetrit (sidomos ata të mazhorancës përballë opozitës), nuk durojnë as pyetjet e gazetarëve dhe as logjikën e analistëve.

Por iu hakërrehen ende pa pa pasur sigurinë e ngrohjes së kolltukut të radhës. Se në këtë vend mjafton ta kesh mirë me atë që të vë në listë, të kesh siguruar financat e nevojshme dhe të tjerat pak rëndësi kanë. Sidomos votuesi. Ky i fundit përherë e më i pakët në kutitë e votimit, po tregon një zgjedhje estetike dhe etike përmes refuzimit për këtë ofertë të pamjaftë. Për këtë çorbë që ofron pas zgjedhje pavarësisht erëzave të shtuara për ta lezetuar.

Shpresa ka humbur në drejtim të paditur, zhgënjimi pas më shumë se tre dekadash është i qartë kristal, ëndrra se gjërat mund të ndryshojnë është

venitur. Një Shqipëri e dyndur drejt Tiranës, të tjerë që ikin si nga sytë këmbët nga ky vend që nuk garanton as sigurinë e së përditshmes, një jetë në furtunë që përkeqësohet nga mediokriteti që drejton, nuk të lënë vend as për idealizëm dhe as për optimizëm.

Pakkush beson sot te shëndetësia falas, te ajri i pandotur, te uji i pijshëm pa orar (që vijon të jetë i papijshëm në fakt), te pyjet vertikale apo orbitale, te shkollat apo çerdhjet pa turne dhe me cilësi, te blerja e një apartamenti me kursimet e një jetë përmes një pune të ndershme, te trafiku i menaxhueshëm apo të ketë ende shpresë të kapë ndonjë parkim. Këto janë thjesht premtime ciklike sa herë ka zgjedhje parlamentare, por janë si ëndrrat e një nate vere që të çojnë veç drejt një dileme shekspiriane: ja vlen të vazhdojë të jetosh dhe të votosh në këtë vend?!

Në fakt, për mos ta mbyllur me nota pesimiste, përgjigja kësaj radhe duhet të jetë, po, ja vlen. Ja vlen të shkundet

vota për një të ardhme pa demagogji dhe të pa mbytur nga zhurmat e propagandës. Për një të ardhme që nuk e do Shqipërinë të braktisur nga bijtë dhe bijat e saj më të mirë dhe që kthehet në një kamp permanent refugjatësh. Për një Shqipëri që garanton standardet minimale evropiane dhe jo përdor BE-në si kartë elektorale.

Për një Shqipëri që orientohet drejt programit dhe ofertës më të mirë politike dhe nuk voton verbazi si turmë e joshur nga deliriumi i lider-surrelit dhe patronazhistët që paguhën me paratë e taksapaguesve për të bërë lojën e pisët të partisë në pushtet.

Për një Shqipëri që duhet të vlejë më shumë se partia, për përfaqësim të merituar bazuar në ata individë me identitet politik të cilët mund ti japim më tepër ngjyrë parlamentit aktual. Ku meritojmë të dëgjojmë debate që përmirësojnë legjislaclacionin, që adresojnë problematika, që ofrojnë politika inovative publike dhe na sjellin më afër me Evropën. Jo me rrotën! Për këtë duhet të shkundim votën!

# RAMA FUSHATË NË ALEANCË ME TV E MËDHA

ANDI BUSHATI

Ky fillim jave u dominua nga jehona mediatike që patën dy dalje publike të kryeministrit. I pari, takimi i tij i munguar me një bloger tejet popullor ndërmjet grupeve të gallataxhinje në Instagram dhe tjetri që kishte të bënte me rievokimin e fotove të tij nudo në një plazh të Francës, këtu e dy dekada më parë.

Po ti shikosh të dyja këto ngjarje, në sfondin e fushatës që ka nisur Edi Rama, ato janë në koherencë të plotë me linjën e vendosur për të folur për gjithçka përveçse për politikë.

Ai e nisi garën elektorale me një shfaqje gjysëm fokl gjysëm tallava, që nuk kishte të bënte fare, as me mandatin katërvjeçar që po mbyllet e aq më pak me atë të ardhshmin.

Ai ka zgjedhur si sllogan të kësaj beteje, pashaportën evropiane 2030, që edhe sikur të ndodhë ndonjë mrekulli hyjnore dhe të bëhet realitet, nuk ka asnjë pikë lidhje me periudhën katërvjeçare për të cilën po kërkon votën.

Po ti shtosh këtyre përqëndrimin tek figura si bufi i kënetës, krahasimet seksiste kundër meshkujve, refuzimin për të zhvilluar një debat publik me rivalin e tij direkt, apo ndalimin e të gjithë kandidatëve rilindas për tu përballur në studio televizive më opozitarët, kuptohet lehtë se shefi i qeverisë kërkon të imponojë një sfidë elektorale pa brendi dhe pa thelb.

Natyrisht, Edi Rama i ka bërë mirë llogaritë e tij. E vetmja gjë të cilës do ti shmanget është qoftë bilanci real për qeverisjen e katër viteve, qoftë ai për dekadën e fundit në tërësi. Ai është i ndërgjegjshëm se edhe ato pak suksese, që mund të numërohen me gishtat e dorës, kanë të gjitha nga pas ndonjë njollë.

Le të marrim përshembull njërën prej tyre që lidhet me veprat e kryera nga Rama 3, tunelin e Llogarasë. Është e vërtetë se ata që do zgjidhnin ta mbronin në një studio televizive mund të përmendnin hovin që ai i jep turizmit në rivierën shqiptare, afrimin e qytetit të Vlorës me brigjet e mrekullueshme të Jonit etj.

Por, nëse ky propogandist rilindas do kishte një kundërshtar apo kritik përballë, flluska do shfryhej shpejt. Boll që të përmendej dëshmia publike e ish zv/kryeministrit, që pati pohuar të ketë parë me sytë e tij se, që në tenderim, u vodhën jo pak por 50 milionë Euro.

Ky episod hipotetik do të ishte identik për pothuajse të gjitha “skuseset” e qeverisë, për të mos përmendur këtu ato ku milionat janë derdhur por “vepra” nuk ekziston fare.

Pikërisht, për të shmangur incidente



të tilla, për të fshirë nga fushata bal-lafaqimin me fakte tronditëse si bur-gosjet e Kokës, Beqajt, Ahmetajt apo Veliajt, për të mos folur për vilat apo apartamentet luksoze me emra të fshehur, tenderat me gjobë deri 40%, vjedhjet e fondeve të BE-së, vanitetin e bashkëshorteve që shpenzojnë qindra mijra euro për të brendëshme, Edi Rama po reket që sfidën për 11 majin ta shndërrojë në gallatë.

Në pamje të parë, deri këtu nuk ka ndonjë anomalë të madhe. Në një garë elektorale secili sfidant ka të drejtën të përzgjedhë strategjinë që i shkon më tepër për shtat. Atë që i fsheh difektet dhe i mbulon mëkatet. Askush nuk mund të pretendojë që një kryeministër të dalë në fushatë për ti thënë votuesve “këtu kam gabuar”, “këto janë pikat e mia të dobëta”.

Në një shoqëri normale, në një vend

që pretendon të quhet demokratik, këtë rol janë të dënuara ta luajnë medi-at. Janë ato që duhet të shndërrohen në watchdog, për të mbrojtur publikun nga gënjeshttrat e politikanëve që ka mbi kokë.

Pra le ta themi troç, këtu faji nuk bie vetëm mbi Ramën që do të na manipulojë, por tek TV e mëdha që i'a mundësojnë një gjë të tillë. Mëkati i kryeministrit nuk është spekulimi gjatë këtij një muaji, por fakti se ka prodhuar një sistem mediatik të nëpërkëmbur prej tij.

Boll të shikosh çdo natë në ekranet e mbrëmjes lajmet kryesore dhe shout e përditshëm politikë. Temat e bëra bajate janë: A do ia dalin partitë e reja? A do e mundë Shehaj-Llapajn? A po krijohet një opozitë e re? A do ikë Berisha po humbi? Tema e vetme që mungon është vetëm një tjetër.

I ndodhur në një emision përballë panelistëve që mbështesin këtë qeveri, i bëra atyre një pyetje të thjeshtë. A keni parë ndonjë speciale në lajme që të bëjë bilancin e qeverisjes katër vjeçare? A keni parë ndonjë emision të rëndësishëm të darkës të ketë si temë: “si jemi qeverisur këto katër vite”? Natyrisht, nuk mora përgjigje. Të tillë as ka pasur e as nuk do të ketë. Pra imagjinoni për një çast.

Një fushatë mund të fillojë dhe të mbyllet, pa u debatuar tema më bazike, më normale, më e pashmangshme: cili është bilanci katërvjeçar i atij që po na rikërkon votën. Televizionet dhe emisionet e mbrëmjes “kanë liri” të diskutojnë gjatë për fatin e atyre partive, që të gjitha sëbashku nuk do të kapin dot as dhjetë deputetë, janë të preokupuar për të ardhmen e opozitës, impakti i së cilës në jetët e

shqiptarëve është afër zeros, por nuk kanë leje të trajtojnë atë që na shqetëson të gjithëve. Dhe kjo ndodh pasi, disa prej urdhrit politik e disa më “të ndershëm” prej autocensurës, nuk shkelin dot në një tokë të ndaluar nga udhëheqësi.

Sesa normale është kjo nuk ka nevojë ta thotë as OSBE-ODHIR, as OJF e shoqërisë civile që vëzhgojnë zgjedhjet. Atë e kuptojnë të gjithë. Çdo kush e di se ndonjë pretendon se ka hyrë në këtë garë pa koalicion, Rama është aleat me 5 bizneset familjare që kontrollojnë mbi 90% të audiencës televizive në vend. Ai po garon së bashu me ata që u jep koncesione dhe leje ndërtimi me emra fiktivë e që u mbyll dosjet kur kanë halle në SPAK. Prandaj ai ka dhe luksin të bëjë një fushatë gallatë pa dhënë llogari dhe pa bërë bilancin e asaj çka ndodhur deri më tash.

## AURENC BEBJA

“The Paris Telegram” ka botuar, të shtunën e 26 marsit 1927, në ballinë, letrën e Qazim Qemal Bej Vlorës, djalit të Ismail Bej Qemalit, për të denoncuar asokohe traktatin italo-shqiptar të Tiranës të 27 nëntorit 1926, të cilën, Aurenc Bebjja, nëpërmjet Blogut “Dars (Klos), Mat – Albania”, e ka sjellë për publikun shqiptar : Shqipëria, në kthetrat e maces

*Nga Qazim Qemal Bej Vlora  
Djali i patriotit të madh shqiptar Ismail Qemal Beu  
Speciale për Telegramin e Parisit*

Shqipërisë, një vend i vogël me një histori të lashtë, dy herë në vitet e fundit i është garantuar pavarësia nga Fuqitë Evropiane. Pasi babai im në Vlorë shpalli pavarësinë e vendit nga zgjedha osmane dhe ngriti flamurin e patriotit Skënderbe, Konferenca e Londrës e pranoi këtë dhe përcaktoi Kushtetutën e Shqipërisë.

Pasoi (pas episodit të vajtueshëm të mbretërimit të Princ Vilhelm Vedit) Lufta e Madhe, gjatë së cilës vendi u kontestua dhe u mbrojt nga Austria dhe Italia. Në vitin 1921, fuqitë e njohën sërish pavarësinë e Shqipërisë dhe Konferenca e Ambasadorëve caktoi kufijtë e saj. Shqipëria u pranua më tej si një anëtare e pavarur e Lidhjes së Kombeve.

Pasi e bënë këtë, Fuqitë dhe Ambasadorët lanë duart nga Shqipëria dhe jo vetëm që nuk bënë asgjë për ta ndihmuar vendin e ri për të ruajtur liritë e saj, por e lanë atë pre e lakmisë dhe xhelozive të fqinjëve të saj më të mëdhenj. Për vendet e tjera të vogla të lindura pas luftës, ndihma dhe këshillat e Fuqive nuk ishin gjë tjetër veçse intriga politike, xhelozitë dhe komplete!

Kur babai im i ndërë ishte President i Qeverisë së Përkohshme (1912-1913), si ai dhe mbështetësit e tij po

## 1927/ LETRA E QAZIM QEMAL BEJ VLORËS, DJALIT TË ISMAIL BEJ QEMALIT, PËR TË DENONCUAR TRAKTATIN ITALO-SHQIPTAR TË TIRANËS TË 27 NËNTORIT 1926



bënin çmos për ta bërë Shqipërinë një komb të lirë dhe që respektonte veten, xhelozitë dhe intrigat që e rrethonin ishin të tilla sa ai nuk guxonte të porosishte mobilje zyre për zyrrat qeveritare nga Austria pa ngjallur zemërimin e italianëve – dhe anasjelltas!

### *Nga e keqja në më keq*

Që nga zgjidhja e statusit të Shqipërisë, që nga lufta, çështjet kanë shkuar keq e më keq, Shqipërisë nuk i është lënë kurrë një shans për të treguar se çfarë mund të bëjë.

Ardhja në pushtet e aventurierit Ahmet Zogu, si Kryetar i Këshillit, me mjete që s'janë aspak një turp për Evropën, është shënuar me intriga, abuzime, terrorizëm dhe vrasje! Vetë shtypi francez dhe ai anglez kanë

vënë në dukje se Ahmet Zogu i kanë mbetur vetëm një grusht burrash besnikë dhe se ai i mban ata vetëm me anë të ryshfeteve — nga vijnë, nuk e dimë, por mund ta hamendësojmë!

Fakti është se e gjithë elita e vendit të vogël, ministra, gjykatës, bejlerë, kryepeshkop, oficerë të lartë e të tjerë, afro njëqind, janë të ekziluuar. Vetëm ky fakt mjafton për të dënuar sundimin e djallëzuar dhe uzurpimin e Ahmet Zogut. Ndonëse disa nga këta të mërguar vullnetarë janë ftuar të kthehen në vendin e tyre, ata nuk do ta bëjnë këtë për sa kohë që Ahmet Zogu është në krye të vendit.

Nuk kam asnjë hezitim të them se Ahmet Zogu ia ka shitur vendin Italisë. Pavarësia e saj, e garantuar solemnisht nga Fuqitë, është sot një

farsë; populli i saj nuk ka zë dhe asnjë mjet reagimi. Pasi, me gjithë caktimin e kufijve nga përfaqësuesit e Fuqive, një pjesë të madhe të territorit ia kishte dorëzuar Jugosllavisë, ky diktator u dha italianëve monopolin e Bankës Kombëtare, e cila u dha atyre supremacinë ekonomike në vend. Kjo u pasua nga Konventa monstruoze e Tiranës, e cila praktikisht ia dorëzoi Shqipërinë, të lidhur duar e këmbë, Italisë.

Këshilli i Ambasadorëve dhe Lidhja e Kombeve kanë qëndruar me qetësi dhe kanë parë këtë paudhësi që i është ofruar një populli të ashtuquajtur të lirë.

Si patriot shqiptar i shkrova gazetës “Le Matin” nga qyteti i Nisës, për të demonstruar në emër të bashkatdhetarëve të mi të pambrojtur, por letrës sime nuk iu kushtua vëmendje.

### *Çfarë po bën Gjeneva ?*

Shqipëria, duke qenë anëtare e Lidhjes së Kombeve, e cila ka njohur pavarësinë dhe integritetin territorial të Shqipërisë, është e pamundur t'i njihet e drejta çdo shteti për të ndërhyrë në punët e brendshme të vendit, madje as për të garantuar kufijtë e tij. Vetëm Gjeneva është e kualifikuar për diçka të tillë, ose për të zgjidhur vështirësitë e jashtme.

Asnjë shqiptar i vërtetë nuk mund të pranojë masat e Presidentit aktual, i cili nuk gëzon besimin e popullit, as ratifikimin e tyre nga Kuvendi apo Senati i Shqipërisë (instrumente të akteve të tij tiranike dhe të ambicieve të tij, të zgjedhur jo nga shumica e popullit, por nga një pakicë e vogël në

pagën e Ahmet Zogut).

Ky Traktat i Tiranës, që ia dorëzon Shqipërinë Italisë, është aq më i rrezikshëm për këtë të fundit, sepse synimi i qeverisë italiane për të aneksuar thjesht dhe puro Shqipërinë është i njohur që nga ardhja në pushtet e zotit Sonnino, i cili bëri që Aleatët të pranonin traktatin e 1905-ës.

Kjo politikë vetëm sa është forcuar që nga ardhja në pushtet e fashistëve dhe i shqetëson më shumë shqiptarët, sepse Traktati i Tiranës i 27 nëntorit 1926 i dha të drejtën e ndërhyrjes së armatosur diktatorit Musolini – fakt që ky i fundit e theksoi shumë kohët e fundit kur deklaroi se nëse Italia nuk do të zgjerohet, ajo do të “shpërthejë”!

Këto fakte më duken mjaft domethënëse dhe duhet të bëjnë të reflektojnë jo vetëm shqiptarët, por edhe ata që janë të shqetësuar për paqen e botës!

Nëse Shqipëria do të ishte lënë e qetë, nëse ajo do të ishte e lirë sot të zgjidhte liderët që donte, do të rezultonte një vend paqësor, i begatë dhe i mirëqeverisur. Por ashtu siç është, edhe pse telashet e tanishme mund të kalojnë për pak kohë, unë dridhem më shumë se kurrë për fatin e vendit tim dhe bashkë me të edhe për të ardhmen e Ballkanit. Një gjë është e sigurt : se vendi që për më shumë se katër shekuj mbështeti zgjedhën e osmanëve, duke pritur gjithmonë me padurim ditën e çlirimit dhe që e hodhi përfundimisht atë zgjedhë, nuk do të tolerojë kurrë, kur ta kuptojë situatën, dominimin e ndonjë vendi tjetër!

## POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

### Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:  
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:  
020 7018 7929  
073 4066 5946



# Akoma nuk keni një website?

*The Albanian*

## Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

 **020 7018 7929**

 **073 4066 5946**  **078 5997 7545**

SHAIP KAMBERI

# BETEJA JONË DO TË VAZHDOJË!

Ne do të jemi të durueshëm dhe këmbëngulës në luftën tonë për një pozitë më të drejtë.

Zgjedhja e kësaj Qeverie të Serbisë paraqet një politikë të kontinuitetit dhe jo një ndryshim thelbësor në drejtimin politik të vendit.

Pra, vazhdim i një politike që ka çuar në kriza të shumta — politike, shoqërore dhe institucionale. Prandaj zgjedhja e saj duket më shumë si përpjekje e regjimit për të ruajtur iluzionin e reformave sesa si një tranzicion i vërtetë politik.

Edhe kjo qeveri formohet në hijen e parregullsisë zgjedhore dhe të cënimit të rëndë të sundimit të ligjit, në një atmosferë të regresit demokratik, gjuhës së urrejtjes ndaj kundërshtarëve, madje edhe kur bëhet fjalë për pjesëtarë të popullit shumicë. Them edhe për pjesëtarët e shumicës sepse gjuha e urrejtjes ndaj pjesëtarëve të pakicave është bërë përditshmëri për përfaqësuesit e pushtetit. Serbia po zgjedh qeverinë e saj të tetë brenda vetëm 13 vjetësh. Mesatarisht, çdo qeveri ka zgjatur më pak se 2 vjet, çka flet mjaft për atmosferën politike të të paqëndrueshme dhe përkohshmerinë e institucioneve të saj.

Ekspozija e kryeministrit, për fat të keq, mohon krizën aktuale politike dhe nuk ofron një vizion të qartë për zgjidhjen e problemeve të mëdha. Veçanërisht shqetësuese është fakti që

çështjet e politikave për pakicat kanë mbetur thuajse plotësisht të marginalizuara, pasi në program nuk ofrohen asnjë zgjidhje për problemet e akumuluar për dekada.

Në një moment kur marrëdhëniet ndëretnike dhe pozita e pakicave janë të vështira, një qasje e tillë nuk kontribuon as në përfshirje, as në stabilitet, as në integrimin e tyre të barabartë dhe të drejtë në institucionet shtetërore. Për shqiptarët, çështja e integritetit në institucionet shtetërore, njohjes së diplomave dhe ndalimit të procesit të pasvizimit selektiv është veçanërisht e theksuar.

Ajo që e diskualifikon më tej këtë qeveri është mungesa e guximit politik për t'u përballur me trashëgiminë e së kaluarës. Asnjë fjali nuk u tha për trashëgiminë e kaluar kriminale, për krimet e luftës dhe për ndëshkimin e përgjegjësve.

Ndaj Kosovës, vijon politika e mohimit të fakteve dhe e refuzimit për t'u përballur me realitetin.

Në vend që të nxisë procesin e përbaljes me problemet politike dhe shoqërore që kanë shënuar mandatet e mëparshme, regjimi ngul këmbë në vazhdimësinë, duke shmangur përgjegjësinë dhe çdo reflektim serioz.

Në tërësi, qeveria e re më shumë ngjan me një ristrukturim kozmetik të



qeverive të mëparshme sesa paraqet një epokë të re politike. Është e qartë se regjimi nuk ka ndërmend të ndryshojë në të vërtetë, por vetëm të ruajë status quon me petkun e ri.

Në këtë kuptim, qytetarët dhe shoqëria në tërësi mbeten peng i një strukture politike që në mënyrë sistematike shmang përgjegjësinë dhe dialogun, dhe në vend të një vizioni, ofron lojalitet ndaj hierarkisë partiake dhe “stabilokracisë” që ka shkatërruar institucionet dhe ka krijuar një demokraci hibride de facto.

Pakicat do të vazhdojnë të jenë të

margjinalizuara dhe të diskriminuara. Pa një plan të qartë për integrimin e tyre në jetën shoqërore të këtij vendi, të drejtat kolektive nuk realizohen me zgjidhje deklarative dhe personale, por me programe konkrete — të cilat mungojnë.

Si përfaqësues i pakicës kombëtare shqiptare dhe si përfaqësuesi i vetëm i tyre politik në këtë kuvend, theksoj se kandidati për ministër për pakicat përfaqëson një nga zgjidhjet më kontroverse kadrovike. Emërimi i tij ngjall shqetësim jo vetëm për shkak të së kaluarës së tij politike, por edhe për shkak të mesazhit se lojaliteti ndaj

regjimit është më i rëndësishëm se profesionalizmi, integriteti dhe përgjegjësia politike.

Kandidati juaj perceptohet në publik si politikan pa një profil të qartë programor, por me lidhje të forta brenda strukturave të pushtetit, çka e bën shembull të “oportunitizmit kadrovik”. Prania e tij në qeveri bazohet në pragmatizëm politik dhe në nevojën për të simuluar përfshirjen, veçanërisht sa i përket përfaqësuesve të komuniteteve pakicë, sidomos asaj shqiptare.

Përdorimi i këtij kandidati si alibi për përfaqësimin e supozuar të shqiptarëve në institucionet e shtetit, do të jetë i dëmshëm për interesat reale të shqiptarëve nga Lugina e Preshevës, por edhe për marrëdhënien e tyre me këtë shtet.

Ky kandidat bëhet simbol i instrumentalizimit të politikës së pakicave në shërbim të marketingut të regjimit. Në një moment kur nevojitet një dialog autentik dhe një integrim i sinqertë i të gjithë qytetarëve, emërimi i tij duket si një veprim cinik që i shërben vetëm propagandës së regjimit. Por mos u shqetësoni, ERËRAT E NDRYSHIMIT po fryjnë në këto anë — do t'ju fryjnë edhe juve. Ne do të jemi të durueshëm dhe këmbëngulës në luftën tonë për një pozitë më të drejtë.

## BIG BROTHER: VIKTIMAT REALE – BANORËT DHE PUBLIKU

NDREK GJINI

Big Brother – Ky program, që pretendon të jetë një “eksperiment social”, në fakt përfaqëson një rrënim të thellë të moralit, psikikës dhe kohzionit shoqëror.

Promovimi i Modeleve Negative: Një Rrezik për Vlerat Shoqërore  
Në qendër të Big Brother shpesh qëndrojnë figura me tendenca narcisiste, manipulatore e të pandjeshme ndaj normave etike. Këta individë shpesh ngrihen në piedestal si “modele suksesi”. Psikologjia amerikane Jean Twenge, në librin “The Narcissism Epidemic”, vëren se “shoqëria moderne ka filluar të shpërblejë pikërisht ato sjellje që dikur përbënin arsye për turp.”

Normalizimi i Sjelljeve të Pa-pranueshme  
Në emër të “lojës”, gënjeshtria, bullizmi, tradhtia e intriga jo vetëm që pranohen, por edhe shpërblehen me famë e përfitime financiare. Sipas Dr. Philip Zimbardo, psikolog i njohur amerikan, “kur sjelljet antisociale shpërblehen publikisht, shoqëria nis t'i perceptojë si normale dhe madje të dëshirueshme.”

Dëmtimi i Shëndetit Mendor – Pjesëmarrësit dhe Publiku si Viktima  
Jetesha nën survejim konstant, ekspoz-

imi ndaj kritikave publike dhe presioni për t'u dalluar shkaktojnë stres, ankth dhe pasoja afatgjata për shëndetin mendor të konkurrentëve. Por ndikimi nuk ndalet aty. Shikuesit, veçanërisht të rinjtë, përjetojnë një ndjenjë të shtrembëruar të realitetit dhe identifikohen emocionalisht me personazhet televizivë.

Dr. Aric Sigman, psikolog britanik, shkruan: “Ekspozimi i zgjatur ndaj programeve pseudo-realitete ndikon negativisht në zhvillimin emocional dhe etik të adoleshentëve.”

Shkatërrimi i Diskursit Publik dhe Rënia e Kulturës Mediatike  
Debatet mbi politikat publike, artin, arsimin apo etikën janë zëvendësuar nga analizat e sjelljes së konkurrentëve, thashethemet dhe klikimet sensacionale. Mediat, që dikur ishin në shërbim të mendimit kritik, tashmë shpërndajnë banalitet si formë argëtimi masiv.

Komercializimi i Jetës Private dhe Intimitetit

Në Big Brother, jeta private bëhet spektakël. Kamera të përhershme, ekspozim ekstrem dhe mungesë kufijsh mes publike dhe private kthejnë gjithçka në një mall për konsum masiv. Kjo zhbën konceptin e intimitetit, duke e shndërruar në një produkt për shitje.



Kultivimi i Konsumizmit dhe Suksesit të Rremë

Aspiratat nuk lidhen më me edukim apo përmbushje personale, por me famën e shpejtë dhe fitimin material. Ky model i deformuar suksesi është veçanërisht i dëmshëm për brezat e rinj që formojnë identitetin e tyre përmes këtyre pasqyrimeve. Degjenerimi Moral dhe Përçarja Shoqërore

Shpesh promovohen sjellje që bien ndesh me normat tradicionale të shoqërisë shqiptare: marrëdhënie të shturura, tradhti bashkëshortore, përdorim vulgar i gjuhës dhe skena erotike të panevojshme. Këto jo vetëm nxisin debat të shfrenuar, por edhe përçarje të theksuara sociale, ku ndjekësit e konkurrentëve krijojnë grupe fanatike dhe përjashtuese ndaj njëri-tjetrit.

Manipulimi i Perceptimit të Realitetit  
Produksioni ndërhyr vazhdimisht për të krijuar narrativa të caktuara, duke përdorur montazhe, ngjyrimet emocionale dhe drama të inskenuara. Kjo krijon një realitet të rremë që publiku e konsumon si të vërtetë. George Gerbner, themelues i teorisë së kultivimit, paralajmëronte: “Media nuk pasqyron realitetin, ajo e formëson atë në mënyrën më të përshtatshme për tregun.”

Symptomë e një krize të thellë kulturore dhe morale

Big Brother është më shumë sesa një program televiziv; ai është një simptomë e një krize të thellë kulturore dhe morale. Ndikimi i tij është i gjerë dhe shpesh i padukshëm, duke ndryshuar mënyrën se si njerëzit mendojnë, ndjejnë dhe sillen.


Është koha për reflektim. Është koha që mediat, shoqëria dhe institucionet të kuptojnë se çfarë çmimi po paguajnë për “argëtimin pa kufij”.

Le ta mbyllim këtë analizë me një thënjë të Viktor Frankl, psikiatër dhe filozof: “Kur një shoqëri nuk është më në gjendje të dallojë mes vlerës dhe antivlerës, ajo shoqëri është në rrezik të humbë shpirtin e vet.”

MA, University of Galway, Ireland

**FOR  
SALE**

**Coffee Shop For SALE NEAR WOOD  
GREEN TRAIN STATION**



## Coffee Shop PËR SHITJE

Good selling price

I hapur prej vitesh  
Me klientele te garantuar  
Mundesit fantastike per zhvillimin  
e biznesit  
Afer stacionit te trenit  
ne Wood Green

Contact Us Whatsapp

**07702576611**



REASONABLE PRICE




REASONABLE PRICE



**07702576611**



## AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?



## AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?



Search Engine  
Marketing



Online  
Advertising



Social Media  
Marketing

PËR ÇDO KONSULTIM  
MUND TË VINI  
NGA ZYRAT TONA



020 7018 7929  
073 4066 5946  
078 5997 7545



**ADRESA E ZYRAVE**  
30 Avenons Road  
London E13 8HT

ARBEN MALAJ

“Politikanët dhe pelenat duhet ndër-ruar shpesh dhe për të njëjtën arsye, sepse bëhen shpesh pis”. Mark Twain

Në skenën politike shqiptare, një fenomen shqetësues që po bëhet gjithnjë e më shumë kritikë, është kriza e thellë e integritetit të munguar apo të deformuar edhe te brezi i politikanëve/liderëve të rinj.

Kjo mungesë e vlerave thelbësore, e shoqëruar shpesh me ambicie makiaveliste dhe babëzi për pushtet, minon demokracinë e brendshme të partive politike, të demokracisë akoma hibride në vendin tonë, minon themelet e institucioneve publike dhe politike, ushqen një klimë politike të paqëndrueshme sociale dhe politike.

Ky deficit integriteti nuk është thjesht një mungesë etike individuale, por një “sëmundje” që po infektion vetëdijen e politikanëve të rinj. Integriteti i munguar apo i deformuar i liderëve të rinj, integriteti i cenuar apo i vetëshitur për hir të një karriere të shpejtë, në aspektin personal është një faktor që e ka përcaktuar rënien e liderëve makiavelistë, duke e paracaktuar fatin e tyre politik, sado vezullues të duket ai në vitet para të shkëlqimit të rremë. Por, mungesa e integritetit të lartë ka pasoja edhe për partitë politike, ku këta liderë parafabrikate lulëzojnë, zaptojnë strukturat drejtuese të forcave politike dhe me bërryla të gjakosur nuk lodhen të spostojnë këdo që i pengon sado pak në ambiciet e tyre për karrierë të lartë, pushtet dhe pasurim të shpejtë.

Shumimi i artificial i tyre çon në rënien e kredibilitetit publik të politikës. Disa nga “sëmundjet” kryesore që prekin këtë brez të ri liderësh janë: Babëzia e pangopur, që nënkupton një etje të pashuar për pushtet politik dhe ekonomik, shpesh e shoqëruar me mjete të paskrupullta, duke verbuar individin, ndaj etikës dhe interesit të përgjithshëm.

Ajo shfaqet në forma të tilla si kapja e institucioneve, korrupsioni, nepotizmi dhe manipulimi i proceseve demokratike. Ambiciet e pakontrolluara, që nënkupton dëshira për ngjitje të shpejtë në karrierë, duke sakrifikuar vlerat etike.

Karriera e subvencionuar, por pa maturinë dhe integritetin e domosdoshëm:

Promovimi i shpejtë pa pasur eksperiencën dhe formimin e nevojshëm çon në vendime të gabuara dhe abuzime me pushtetin. Arroganca si kulturë e përditshme dhe pasojat e saj: Një tjetër dimension i kësaj krize është arroganca, që është kthyer në një kulturë dominuese të punës së përditshme të politikanëve.

Në librat e shenjtë këshillohet se: “Kurrë mos i bëj askujt atë që ti nuk do që ata ta bëjnë ty”.

Disa raste konkrete të arrogancës së pa shpirt janë: Dëbimi i familjeve në

mes të dimrit për interesa publike.

Mallkimi i gjysheve me fëmijët e porsalindur në mes të dimrit, është mallkim zemre të lënduar dhe ai mallkim të zë.

Shkatërimi i Teatrit Kombëtar, si një pjesë jetike e kulturës sonë kombëtare, ndërsa mbrohet vila e ish-diktatorit. Shkatërimi nga Policinë Bashkiake duke ua shkelur me këmbë fermerëve të varfër perimet që shesin për të blerë ilaçe për nipërit dhe mbesat e tyre deri në mbijetesë, është mallkim që del nga zemra.

Ky lloj mallkimi të zë. Vendosja e gjobave të parkimit që rëndojnë mbi qytetarët me të ardhura të ulëta që i kanë makinat mjete mbijetesë dhe jo mjet luksu të zë. Përpjekjet për të nënshtruar median e lirë përmes favoreve dhe sulmeve digjitale.

Kjo arrogancë, e shoqëruar me babëzinë për pushtet, ka krijuar një klimë ku liderët pa integritet dhe arrogantë pa asnjë kufi etik shihen si “armiç”, që meritojnë “vrasje politike”. Vetëvrasja Politike si Pasojë e Mungesës së Integritetit: Pyetja qendrore e ngritur është nëse

liderët me mungesë të theksuar të integritetit publik po “vetëvriten” politikisht? Përgjigja duke parë edhe zhvillimet e fundit me ne Shqipëri është pohuese.

Kjo “vetëvrasje” buron nga mungesa e integritetit njerëzor dhe politik, nga lakmia për pasurim të shpejtë dhe nga zgjedhja e një formati “politikani parafabrikate”.

Këta liderë vetëvrasës karakterizohen nga babëzia e palimituar (shumë prej tyre po përballen me drejtësinë), mbështeten në karrierën e tyre edhe tek individë apo grupe me CV kriminale, janë thellësisht makiavelistë në përdorimin e mjeteve të paskrupullta për karrierë.

Ata janë të shurdhër dhe kanë mungesë ekstreme të ndjeshmërisë ndaj kritikave dhe e ndërtojnë karrierën e tyre tek mbështetja jo e pakushtëzuar dhe manipulimi i medias për t’i mitizuar ata, njëkohësisht e kërkojnë garancinë për karrierën e tyre të shpejtë dhe të pamërituar kryesisht tek faktorë të jashtëm.

Në luftën për të nënshtruar çdo media kritike, në shërbim të babëzisë, mund

të përfshihet rasti i mbylljes joligjore dhe në urgjencë dhe me çdo çmim të televizionit të “Becchettit” dhe shkatërimi në mënyrë barbare i kompleksit të kompanisë “Hysenbelliu”, në mes të sezonit turistik dhe në panik të plotë për pushuesit. Mentaliteti diktatorial se kush më sulmon mua, do të përfundojë si Becchetti dhe Hysenbelliu, do t’u rëndojë shumë rëndë takapaguesve shqiptarë, të cilët do ta paguajnë babëzinë për pushtet, do të paguajnë qindra miliona euro për shkak të vendimeve të nxituara dhe arrogante të liderëve.

Ndryshe nga Presidenti Obama që tha: “Unë u bëra President i Amerikës se asnjëherë nuk kisha thënë më parë se duhet të bëhem president”, liderët parafabrikatë shqiptarë e fillojnë karrierën e tyre për pushtet të kufizuar politik dhe ekonomik me një strategji shpëlarjeje truri/washing brain, se ata janë të përzgjedhur të zotit, kanë mbështetje ndërkombëtare dhe mund të shtypin këdo që iu del përpara si pengesë për ambiciet e tyre.

Ata investojnë në media për të krijuar idenë se vendi i dytë është zënë në lidhshirin politik të partive të tyre. Ata

japin mesazhin se i dyti do të jem unë, prandaj përqendrohuni tek unë, punoni për mua, financoni për mua. Por ambicia e tepruar dhe mungesa e durimit shpesh çojnë në dështim politik.

“Politikanët dhe pelenat duhet ndër-ruar shpesh dhe për të njëjtën arsye, sepse bëhen shpesh pis”. Ky konkluzion cinik thekson nevojën alarmante për një ndryshim rrënjësor në kulturën politike.

Duhet të ndalet promovimi i liderëve me integritet të dobët, të cunguar dhe të deformuar. Fatkeqësisht, edhe përzgjedhjet personale të kryetarëve të partive që kanë formën e kompanive private me një aksioner të vetëm për zgjedhjet parlamentare 2025, kanë pasur si kriter përzgjedhës vetëm besnikërinë e verbër ndaj liderit, edhe pse integriteti i tyre publik dhe politik është i cenuar rëndë.

Nëse përfaqësimi politik nuk ndryshon, nëse nuk reduktohet në thelb promovimi i liderëve pa integritet të lartë, e ardhmja e demokracisë sonë do të jetë e zymtë, zhgënjyese dhe penguese për të ardhmen tonë, më të mirë se e shkuara dhe e tashmja.



ANDI MUSTAJ

# GRUAJA, PORTRETI I KONTRASTIT TË DY FUSHATAVE

Në fundin e çdo dite të derimëtanishme, e kam të vështirë të sintetizoj në mendime dhe ndjesi morinë e gjithçkaje jam duke kaluar si zëdhënës i kësaj fushate elektorale, ndonëse në kaosin përmblyllës të çdo dite, nuk kam mendim tjetër veç mirënjohjes ndaj fatit dhe njerëzve që më lejuan ta përjetoj këtë përvojë, përvojë të cilën ritmi drejt qëllimit të fitores më privon ta shoh thjesht dhe vetëm si të tillë. Falë kësaj detyre, prej ditësh jam i përfshirë në disa dimensione të zhvillimit të kësaj fushate zgjedhore, prej rigorozitetit dhe striktësisë së takimeve zyrtare tek natyrshmëria për ta liruuar kravatën përballë zemrës së hapur të qindra mijëra shqiptarëve në çdo cep të vendit.

I ka patur deri më tani të gjitha nuanca kjo fushatë e jona, prej thelbit tek emocioni, prej kujtesës për çfarë ishim tek vizioni për çfarë do të jemi, prej reflektimit tek vetëbesimi, të pashtrur në përpjekje për të qenë ekipi i fortë blu që sigurohet ta shijojë fitoren që kërkon me ngulmin e kokëfortësisë pa negociuar dinjitetin, pa kompromentuar modelin, pa devijuar nga boshti i shembullit të Shqipërisë me ne. Dëshmitar i këtyre, në bllokun e shënimeve të mendjes a të dorës, nuk i kam shpëtuar dot edhe në intensitetin e këtyre ditëve, reflektimit.

Një i tillë ishte përpara pak ditësh një takim me zonjat, gra dhe vajza kandidatë për deputete të Partisë Demokratike dhe Aleancës për Shqipërinë Madhështore në qarkun e Tiranës, një takim i ngushtë që për mua përbën kopertinën e doktrinës ndonëse të pashtruar të kësaj fushate zgjedhore. Zonja me mendime të forta në butësinë e natyrës hyjnore. Në ashpërsinë thuajse të gurtë të terrenit politik shqiptar, i perceptova jo më pak se personifikim të stoicizmit. Jo se nuk e njoh gruan shqiptare për të tillë, por sepse në këtë fushatë zgjedhore kontrasti me reflektimin që kanë



përballë i bënte ato në sytë e mi kaq stoike.

Në ligjërimin e secilës prej tyre shihja të shpalosur mes fjalëve të njëjtën filozofi pune, të njëjtën qasje karakteriale, të njëjtin model gruaje. Sipërmarrëse, akademike, artiste, avokate, diplomate, aktiviste etj., politikisht Cecilia prej tyre përngjante kaq denjësisht udhëheqëse. Udhëheqëse në mënyrën se si përçonin takimet me qytetarët, si investoheshin në kritikë dhe autokritikë për të përmirësuar më shumë ofertën tonë ndaj shqiptarëve, udhëheqëse në sigurinë me të cilën rrëfenin se drejtonin diskursin politik në terren po njësoj si në këtë takim, në ballë të fushatës duke i qëndruar stoike modelit të vlerës, fisnikërisë, guximit për të kërkuar privilegjin e përfaqësimit me zotësi, aftësi dhe vetëm punë.

Nuk bëra dot më shumë gjatë këtij leksioni politik se sa të ndihesha kre-

nar për gruan demokrate, për mua portreti i fushatës sonë zgjedhore. Si ishin zonjat deputete sot, është fushata jonë prej ditësh së parë të startit të kësaj maratone.

Është e vërtetë se kundërshtari nuk zgjidhet, por sa i pafat paska qenë ky vend për ta përjetuar politikisht një garë ku kontrasti i fushatave dhe modeleve është kaq i mprehtë, një hendek i thellë deri në errësirë. Teksa zonjat kandidatë zhvillojnë takimin me liderin demokrat, imponuese në mendim po aq sa në vizion, nuk e ndalova dot pavetëdijën e të krahasuarit të tyre me zonjat e kampit përballë. Në respektin ndaj figurës së gruas, kurrë s'do të mundja të hamendësoja padenjësinë e këtyre të fundit për të qenë përfaqësuese politike, por a mund të jenë ato një model në fushatën që u ka rënë për hise?

Rreshtuar shpesh në takimet e estradës së cirkut të "one man show"

i kam parë kokulura, jo rrallë herë me gesticulacione të parehatisë dhe sikletit sa herë lideri i tyre shfrenon fantazinë verbale në funksion të fushatës së batërdisë që ai mendon se ushqen turmën. A mund të jetë e tillë një grua udhëheqëse, e paaftë për të mbrojtur dinjitetin e saj në partinë tek e cila ka zgjedhur të investojë kohë, punë, vizion? Ka prej tyre edhe të përshatura më me lehtësi në funksion të elozheve për liderin, pak minuta pasi vetë ai ka njolesur çdo kod të etikës dhe komunikimit njerëzor. A mund të frymëzojë i tillë model gruaje, ajo që as përdhosja e karakterit njerëzor me fyerje sa banale aq edhe bulliste, as vulnerabiliteti me të cilin fëmijët bëhen pjesë e tentakulave të ndyta në komunikimin e kryeministrit, as lëndimi i plagëve njerëzore, nuk i nxjerr nga kllapia e mosreagimit? Ato rreshtohen nënshtruar vullnetit të tij për ta bastarduar deri në skaje fushatën zgjedhore të socialistëve. Është dhe ky një model gruaje, por

kurrësi i gruas shqiptare, aq më pak asaj shtetare në politikë.

Dinamizmi i orëve të gjata të secilës ditë ma shpjegon arsyen pse fushatat zgjedhore mbahen mend gjatë. Kësaj radhe, me shikim më të kthjellët si zëdhënës i kampit blu, kam bindjen se kujtesën kolektive do ta shënjojë shumë më shumë se dimensionin politik i fushatës, dimensionin social i saj manifestuar në këtë kontrast të frikshëm modelesh, dy modele gruaje, dy modele fushatash. Dëshmohej në narativen e çdo dite, përplasja e dy fushatave, një kontrast si me thikë që ndan dy botë politike. Gruaja udhëheqëse përballë gruas së intimiduar; modeli i dinjitetit, fisnikërisë, vlerës, përballë modelit të përçartjeve emocionale dhe karakteriale shpërthyer pa drojë në një kamp ku nënshtrimi ndaj dëshirave edhe komunikative të liderit është kusht mbijetese, edhe për gratë.

Në kushte të tjera do të ndihesha ndoshta i paretuar në dyshimin se a perceptohet ky kontrast modelesh tek shqiptarët. Nuk i kanë lënë vend këtij dyshimi takimet ndonëse kalimtare me burra, djem, gra e vajza në këto ditë që do t'i quaja pelegrinazhi më afër shqiptarëve, më afër Shqipërisë. Kudo ku shkelim për të kërkuar votëbesim ndiej sa pranë tyre është modeli ynë, sa larg shqiptarit është modeli i tyre. E përfaqëson grua demokrate forcën dhe dinjitetin e gruas shqiptare, e përfaqëson modeli ynë lirinë, vlerat, parimet që udhëheqin shqiptarët. Janë ata kaq të huaj, ndaj sa fort bërtet ky kontrast, nuk kam më asnjë dyshim!

\*Andi Mustafaj - Zëdhënës i Fushatës Elektorale të Partisë Demokratike dhe Aleancës për Shqipërinë Madhështore

## POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

### Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:  
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:  
020 7018 7929  
073 4066 5946



VETON SURROI

Ulqinakët janë ngritur kundër “dubaizimit”, procese çfarë po kalojnë Serbia e Shqipëria me kontrata të nënshkruara nga pushtete që janë larguar nga identiteti demokratik dhe normat e transparencës e ligjit. Kjo mund të jetë kauzë për tërë vendin dhe demokracinë në të

1.

Dy zhvillime po bëhen në Mal të Zi brenda këtyre pesë vjetëve, që të dyja në një formë a tjetrën përcaktojnë një pjesë të identitetit të këtij shteti dhe që në të dyja aktorë të një peshe specifike po bëhen shqiptarët.

Në të parin, më 2020, ç’është e vërteta, nuk u bë i tërë komuniteti shqiptar i këtij vendi, por vetëm njëri pjesëtar i saj, kryeministri Abazović. I zgjedhur në këtë post si një kompromis i dëshiruar (a projektuar) mes dy taborëve politikë të antagonizuar në këtë shtet, të atij të identifikuar me pushtetin e pakontestuar të Gjokanoviçit prej zgjedhjeve të para shumëpartiake dhe atij opozitat në të identifikuar në masë bukur të madhe me politikën proserbe, kryeministri Abazović në emër të Malit të Zi nënshkroi Marrëveshjen themelore mes këtij shteti dhe Kishës ortodokse serbe.

Edhe po të mos kishte qenë shqiptar, një gjest i këtillë do të ishte kundërthënës, për vetë faktin se kundër kësaj marrëveshjeje ishte një pjesë e konsiderueshme e popullatës, e cila në zgjedhjet e porsambajtura i kishte fituar pothuajse gjysmën e mandateve në Kuvend.

Fakti se ishte shqiptar nuk ishte ndihmesë; në rastin më të mirë ai duhej të konsideronte se ishte i pafuar për t’u marrë me një dokument që ka ndikim në çështjet identitare të Malit të Zi, relacionin mes kombit malazias dhe atij serb, si dhe relacionin gjithëherë delikat mes pavarësisë së këtij shteti dhe përpjekjes për dominim nga ana e pushteteve të ndryshme të Serbisë.

Imazhi më i shëmtuar i këtij veprimi nuk ishte nënshkrimi jopublik i Marrëveshjes me një delegacion që erdhi fshehtëzi e i rrethuar me policë speciale, por marrja e detyrës nga ana e mitropolitit Joanikije në një desant me helikopter në Cetinë, së bashku me kreun e Kishës Ortodokse Serbe, Porfirije, përderisa një numër qytetarësh malazezë kundërshtonin këtë akt, ngase objektin sakral në Cetinë e konsideronin si pjesë të identitetit të vet.

2.

Mali i Zi tash ballafaqohet me një sfidë tjetër identitare dhe sërish kanë rol shqiptarët. Qeveria e këtij vendi ka nënshkruar një marrëveshje strategjike (ndonëse kësaj here jo në rrethim të policisë speciale) me



“Eagle Hills”, kompania e njohur e biznesmenit të Emirateve të Bashkuara Arabe, Mohamed Al Alabbar. Kësaj here çështja nuk ka të bëjë me gjuhën, fenë apo prejardhjen etnike, por megjithatë është një kontest mes qytetarëve dhe pushtetit për identitetin e Malit të Zi. Madje, të njëjës prej çështjeve kyç identitare të natyrës së shtetit, të përdorimit të begatit të tij për nevojat e qytetarëve të vet.

Beteja ka filluar në Ulqin, qytet me shumicë shqiptare dhe me një traditë besimtarësh myslimanë në mesin e kësaj popullate. Por, për dallim prej fërkimeve të tjera identitare, ky nuk ka të bëjë as me përkatësinë etnike e as me çështje besimi.

Komuniteti i Ulqinit, i parë nga kryetari i komunës, po e kundërshton një marrëveshjen mes Malit të Zi dhe “Eagle Hills” nisur nga një premisë e thjeshtë: të mirat e Ulqinit duhet të shfrytëzohen ekonomikisht dhe parësisht nga ky komunitet.

“Eagle Hills” pretendon që me tokë të falur nga shteti (dhe nxitje të tjera fiskale) ta zhvillojë Plazhin e Madh; ulqinakët pretendojnë se këtë mund ta

bëjnë vetë, madje se janë duke e bërë dhe kështu ia sigurojnë vetes mirëqenien.

Pyetja të cilën ulqinakët e kanë shtruar është konceptuale: pse të japim tokën tonë publike e të punojmë për “Eagle Hills”, kur mund të punojmë për familjet e komunitetin tonë?

3.

Pyetja e ulqinakëve tejkalon komunitetin e tyre dhe, siç u pa këto ditë, arriti të jetë njëra prej çështjeve themelore të konfliktit politik në shtet, madje u integrua edhe në konfliktin mes kryeministrit dhe presidentit të vet, dikur bashkudhëtarë në rrëzimin e pushtetit të Gjokanoviçit.

Madje kjo pyetje e tejkalon edhe vetë konfliktin politik (që mund të ketë burime të ndryshme nga e kaluara, përfshirë edhe çështjen e Kishës). Pyetja ka të bëjë me natyrën e pushtetit dhe të vetë shtetit.

Kontratat e ngjashme çfarë i ka propozuar “Eagle Hills” Malit të Zi janë nënshkruar dhe zbatuar në Serbi e Shqipëri. Në që të dyja qytetarët kanë marrë vesh pak gjë nga përfaqë-

suesit e tyre (presidentit të Serbisë dhe kryeministrit të Shqipërisë). Që të dy liderët kanë shpjeguar pak a shumë se si investimi nga “Eagle Hills” do ta “dubaizojë” vendin e tyre - Beogradin me ndërtesa të larta në lumë e Durrësin me ndërtesa luksoze përreth ish-portit.

Që të dy liderët kanë lënë jashtë shpjegimet se përse do dhuruar tokë e dhënë nxitje taksash, përse natyra jokompetitive e projekteve dhe përse shumica e cilën do ta fitojë shteti brenda 20 vjetësh nuk mbulon arsyeshmërinë ekonomike të marrëveshjes.

Dhe, që të gjitha palët kanë qenë të dakorduara me fshehjen e burimeve të financimit, një mënyrë që mund të inkurajonte këdo që ka para nga kudo e të fituara në çfarëdo forme të sjellë, siç i konvenon atij dhe të jetë investitor.

Natyrë e pushteteve që kanë nënshkruar këto kontrata me “Eagle Hills” ka qenë dhe është duke u larguar në formë konsekuente nga kontrolli demokratik dhe duke u afruar gjithnjë e më shumë drejt kon-

trollit të personalizuar, autokracisë.

4.

Beteja e ulqinakëve tashmë mund të jetë duke u ndërtuar si beteja e Malit të Zi për të mbrojtur njëkohësisht sovranitetin e vet ekonomik dhe të natyrës demokratike të shtetit. Këtu mund të hyjë edhe mbrojtja e identitetit dhe ekologjisë së vendit; përse Mali i Zi të mos i përngajë vetes, por duhet t’i përngajë Dubait?

Ndërsa më 2020, një shqiptar u përfshi i pafuar në një çështje të ndjeshme identitare, kësaj here një komunitet shqiptarësh (në mesin e tyre edhe ish-kryeministri Abazović) janë duke e ndërtuar një kauzë së bashku me qytetarët e tjerë të këtij vendi për mbrojtjen e sovranitetit (ekonomik) të Malit të Zi.

Dhe, kjo kauzë mund të bëjë edhe më shumë për shëndetin identitar të këtij shteti.

Beteja vazhdon, e në të qytetarët e Malit të Zi mbase do të tregojnë se a mund t’i bëjnë ballë një modeli, i cili forcoi pushtetin gjithnjë e më jodemokratik në Serbi e Shqipëri.

# A DËSHIRONI TË BËHENI ELEKTRIÇIST I KUALIFIKUAR?

## A DËSHIRONI GOLD CARD?



**18 edition - Level 3 Award in the  
Requirements for Electrical  
Installations BS 7671:2018**

**EAL Level 3 Award in Electrical  
Installation Inspection,  
Testing, Certification and  
Reporting 603/2625/6**

**501/1605/8 Installing  
Electrotechnical Systems and  
Equipment NVQ**

**AM2 Assessment of  
Occupational Competence**



**[www.collegeoflondon.org.uk](http://www.collegeoflondon.org.uk)  
[info@collegeoflondon.org.uk](mailto:info@collegeoflondon.org.uk)**

